

Publikimi i këtij materiali u mundësua me mbështetjen financiare të projektit “Mbështetje për Përfshirjen Sociale të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane”. Pikëpamjet e shprehura në këtë material nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose agjensive të saj.

Projekti synon fuqizimin social dhe ekonomik të komuniteteve të marginalizuara Rome dhe Egjiptiane nëpërmjet: planifikimit me pjesëmarrje për zhvillim infrastrukturor, fuqizim kapacitësh për organizatat e shoqërisë civile Rome dhe Egjiptiane, promovim sipërmarrje dhe punësimi, si edhe mbështetje për institucione të qeverisjes lokale dhe qendrore në arritjen e objektivave të Dekadës së Përfshirjes së Romëve.

Projekti zbatohet në tre rajone: Korçë, Berat dhe Vlorë. Financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.



*Empowered lives.
Resilient nations.*



IDE PUNËSIMI KRIJUESE DHE JO TRADICIONALE

Ideja për këtë botim lindi si një reflektim ndaj ideve të ndryshme inovative të biznesit, si një nevojë për të dalë nga qarku i profesioneve dhe ideve rutinë dhe të vjetëruara që tashmë i njohim dhe si një motivim për ti ndarë ato më pas me sa më shumë të interesuar me qëllimin e vetëm për të orientuar dhe ndihmuar të gjithë ata që duan të fillojnë një biznes ose aktivitet të ri me sa më shumë shanse suksesi.

Ky libër ndan me ju 100 ide të ndryshme të cilat mund të shfrytëzohen në forma të ndryshme sipas kushteve dhe faktorëve njerëzorë, fizikë, gjeografikë, kulturorë dhe financiarë. Këto ide mund të shërbejnë për përmirësimin e gjendjes social ekonomike të grupeve të ndryshme si të rinj, familjarë, nëna të reja apo edhe persona nga kategoritë në nevojë, përmes vetë-punësimit, aktiviteteve që gjenerojnë të ardhura, bashkëpunimeve me biznese konkurruese, nismave në skuadër ose bizneseve sociale.

Idetë në këtë libër nuk mund të merren si të pandryshueshme në çdo rast. Qëllimi ynë është të nxisim, tek lexuesit e këtij botimi, mendimin krijues gjatë kërkimit të punësimit apo vetë-punësimit si edhe idenë se në rast se i shohim gjërat që na rrethojnë ndryshe çdo gjë mund të shërbejë si mundësi. Disa ide janë të thjeshta, disa më komplekse kurse disa të tjera janë rezultat i një pune kërkuese dhe të përshtatura. Ajo që i bashkon të gjitha idetë është fuqia që ato sjellin pasi i lexon dhe ky është edhe qëllimi madhor që ne duam të përcjellim.

Shumë prej ideve janë mundësi e mirë për vetë-punësim ndërkohë që disa të tjera shërbejnë si motivim për ngritjen e një aktiviteti më të strukturuar sipas të gjitha rregullave të tregut. Është shumë e rëndësishme të kuptojmë ndryshimin mes hapjes së një “biznesi” dhe një aktiviteti “vetë-punësimi”. Vetë-punësimi është ajo çka shumë njerëz krijojnë kur përpiqen të ndërtojnë biznesin e tyre por i vetmi ndryshim është se punon për vete dhe nuk ka një “shëf”. Pa dyshim që kjo është diçka e pëlqyeshme por mund të ketë edhe vështirësi në të njëjtën kohë. Nëse vetë-punësoheni ju do të bëni të njëjtën punë të cilën do të bënit për dikë tjetër por në këtë rast e bëni për veten tuaj.

Megjithatë i mbetet lexuesit dhe përdoruesit të këtij manuali idesh të vlerësojë se cila prej ideve përshtatet më shumë sipas karakteristikave të gjithësecilit.

TË MENDOSH “JASHTË KORNIZËS”

Pse një ide mund të konsiderohet e ndryshme ose “Jashtë Kornizës”?

Në fillim le të shohim idetë normale “**Brenda Kornizës**”! Cilat janë kriteret pse ne zgjedhim ide brenda Kornizës?

- Janë ide të praktikuara dhe me risk të ulët
- Janë të pranuar gjerësisht nga shoqëria dhe të njohura zyrtarisht
- Por janë pa shume krijim dhe jo të ndryshme

Tani, le të kthehemi përmbys dhe të shohim çfarë ofron gjendja “**Jashtë Kornizës**”?

- Aftësi në menaxhimin e rrezikut
- Të menduarit ndryshe
- Identifikim i nevojave sociale dhe lidhja e tyre me aktivitete përkatëse
- Nxitje e punës krijuese në grup

ÇËSHTJET KRYESORE TË KËTIJ MANUALI

IDE TË NDRYSHME DHE JO TRADICIONALE VETË-PUNËSIMI

- Të adaptuara sipas kushteve Shqiptare
- Të zbatueshme për të gjitha kategoritë
- Me kosto të ulët
- Nxitje për biznese sociale
- Ndryshim i mënyrës së të menduarit
- Mundësi për të ndryshuar realitetin

SEKTORËT

- Turizëm
- Tregëti
- Bujqësi / Blegtori
- Menaxhim
- Argëtim
- Shërbime
- Prodhim
- Etj

DISA MUNDËSI FINANCIMI

Institucione financimi për sipërmarrjen e të rinjve dhe biznese sociale me norma të zbutura, prezente në Shqipëri 1

- NOA Financojmë <http://www.noa.com.al/>
- KIVA <http://www.kiva.org/partners/239>
- Vision Fund <http://www.visionfund.al/index.php/en/>
- AIDA / Fonde Shtetërore për të rinjtë <http://www.aida.gov.al/>
- Yunus Social Business <http://www.yunussb.al>
- Fondi Besa <http://www.fondibesa.com/>

1 Institucionet e përmendura në këtë listë janë vetëm disa nga ato që ofrojnë kreditime të zbutura për nisma të vogla ekonomike.

Mundësi financimi të tjera në formë grantesh ose me norma normale kreditimi

- Grante nga Fondacione ose organizata jo qeveritare
- Bankat e nivelit të dytë
- Biznesi Privat
- Pushteti Lokal (në disa rajone)
- Gjenerim i pavarur fondesh

AVANTAZHET

- Ide të panjohura më parë
- Lidhje e nevojave me shërbimet
- Nxitje e të punuarit në grup
- Përfshirje e të rinjve
- Nxitje e mendimit krijues jashtë kornizës
- Lidhje e kulturës me gjenerimin e të ardhurave
- Rritje e shanseve për punësim

MATERIALE PËR SIPËRMARRËS TË RINJ

- Rini Sipërmarrëse – Udhëzues praktik http://aida.gov.al/rini_sipermarrese.pdf
- Shërbimi Kombëtar i Punësimi <http://www.kerkojpune.gov.al/>



DYQAN ANTIKE

1 DYQAN ANTIKE

Sektori: Tregëti, Shërbime, Kulturë, Aktivitet Familjar

Përshkrimi: Në rast se jeni i apasionuar pas objekteve të vjetra, ju pëlqen të koleksiononi, i prodhoni vetë ato dhe keni njohuri mbi kulturën dhe historinë atëherë një dyqan i vogël artikujsh antik është një ide e mirë për ju. Ky dyqan nuk kërkon shumë kapital dhe mund të plotësohet kohë pas kohe me artikuj të tjerë. Turistët apo vizitorë të ndryshëm i vlerësojnë sendet e vjetra dhe kjo ide mund të ndihmojë që shumë prej artikujve që mund tju duken pa vlerë të shiten duke sjellë një mënyrë përfitimi për ju.

Kapitali i Nevojshëm: 150,000 – 300,000 Lekë

Vendi Ideal: Çelësi i kësaj ideje është vendndodhja e aktivitetit. Për shumë zona kjo ide do të ishte diçka pa interes por në rast se e organizoni në pika kyçe të rrahura nga vizitorë të ndryshëm kjo do tju sillte shumë avantazhe. Vende të përshtatëshme do të ishin: rrugët kryesore, hyrjet e objekteve historike apo të kultit, qendra tregtare, zona me dëndësi njerëzish etj.

Numri i Personave: 1 – 2 persona



2 SHITJA E LIBRAVE TË PËRDORUR


Sektori: Edukim, Shërbime, Informacion, Aktivitet lëvizës

Përshkrimi: Kjo ide ka të bëjë me tregëtimin e librave të përdorur të cilët mund të mblidhen nga njerëz të ndryshëm të cilët i shesin ato për arsye të ndryshme apo nga burime të tjera. Megjithë rolin e madh të internetit në ditët e sotme libri përsëri ka një rol të veçantë dhe të pazëvendësueshëm në shoqëri për vlerat që mbart. Por duke qenë se shumë njerëz nuk mund të përballojnë blerjen e një libri për shkak të kostove të larta ideja për të blerë libra të përdorur është një mundësi shumë e mirë si për blerësin ashtu edhe për atë që i shet ato.

Kapitali i Nevojshëm: 100,000 – 200,000 Lekë (libra, tavolina, stenda)

Vendi Ideal: Kjo ide mund të zbatohet si një aktivitet në një vend të qëndrueshëm ose si aktivitet lëvizës në zona të ndryshme. Vendet ideale: pranë institucioneve arsimore, në tregje, qendra qyteti apo rrugë të populluara.

Numri i Personave: 1 person



3 HOTELI I MISRIT

Sektori: Argëtim, Turizëm

Përshkrimi: Brënda një parcele misri mund të ndërtoni një minihotel i gjithi i përbërë nga materiale natyrore. Krijoni një hapësirë në mes të parcelës në formë katrore dhe kjo do të jetë dhoma e gjumit së bashku me ambientet lehtësuese për një natë në qiell të hapur. Nje tendë me katër këmbë (mund ta blini me çmim shumë ekonomik) do të shërbejë si mbrojtëse dhe kufi për dhomën e gjumit e cila poshtë vishet me blloqe / kubikë bari të thatë. Këto blloqe krijojnë dyshekun. Gjithashtu me blloqe të tilla prej kashte mund të krijohen jashtë kësaj tende edhe ambiente të tilla lehtësuese si ai i ngrënies dhe i shlodhjes. Kjo hapësirë mund të jetë e përshtatëshme për 2 ose 4 persona dhe ju mund ti ofroni produkte të ndryshme ose mund të konsumohen produkte që vizitorët i sjellin personalisht.

Kapitali i Nevojshëm: 100,000 – 200,000 Lekë (materialet)

Vendi Ideal: Zona Rurale pranë qyteteve dhe të arritshme

Numri i Personave: Për realizimin e saj mund t'ju nevojitet edhe një staf me kohë të pjesëshme (mundësisht banor i zonës).



4 Mbledhja e mbeturinave shtëpiake derë më derë

Sektori: Shërbim

Përshkrimi: Mund të provoni të organizoni një shërbim të strukturuar për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave shtëpiake te banorëve nga dera e tyre tek pikat e grumbullimit duke i lehtësuar shumë prej tyre nga shqetësimi i mësipërm. Tirana është një qytet i madh dhe një përqindje sado e vogël e familjeve që do ti përgjigjen këtij shërbimi përbëjnë një numër të konsiderueshëm për të mbajtur këtë biznes me të ardhura pozitive. Gjithashtu ky aktivitet mund të organizohet edhe në qytete të tjera të mëdha.

Çfarë duhet të kemi parasysh për të organizuar këtë ide? Në fillim testohet një zonë e qytetit e populluar me familje të një shtrese normale dhe të lartë si edhe me biznese të ndryshme. Të dy këto subjekte (familjar dhe biznese) mund të kenë nevojë për shërbimin tuaj. Duke e testuar në një zonë të përqendruar ju mëson shumë për detajet dhe vazhdimin e mëtejshëm të idesë dhe ju konsolidon në shërbimin që do të ofroni. Ky shërbim mund tu ofrohet klientëve gjatë një periudhe kohe te caktuar të ditës në mënyrë që klientët të përgatisin mbeturinat e tyre dhe ti vendosin tek dyert e banesave për tu mbledhur nga stafi.

Kapitali i Nevojshëm: 300,000 – 500,000 Lekë (reklamë, uniforma, qese mbeturinash, mjete lëvizëse etj)

Vendi Ideal: Zona urbane, zona të populluara

Numri i Personave: Stafi që kërkohet për një aktivitet të tillë varion në varësi të shtrirjes që do të kenë shërbimet. Si fillim mund të fillohet me dy deri në katër persona të cilët nuk kërkohen me kualifikim të lartë për të kryer këto detyra. E rëndësishme është trajnimi i tyre për pjesën e komunikimit me klientët dhe orientimi me zonën ku gjenden klientët e ndryshëm.



5 KINEMA BAR NË TERRACË

Sektori: Argëtim

Përshkrimi: Në morinë e shumtë të lokaleve, bareve apo ambienteve të shumta argëtuse por pa shumë dinamikë dhe të zhurmshëm atëherë ky është biznesi që bën ndryshimin. Ka shumë persona që duan diçka më të qetë për pasditet e tyre me miqtë dhe në këtë rast kombinimi i disa elementëve së bashku si edhe ndërthurja e tyre në një formë të thjeshtë do t'ju sjellë një ide gjeniale.

Kjo është një ide që nuk kërkon shumë mund dhe investim dhe mund të konsiderohet si ide sezonale sidomos gjatë muajve të ngrohtë të vitit.

Për këtë ide ju nevojiten:

- Taracë me qera
- Videoprojektor
- Tavolinë shërbimi
- Stola dhe tavolina druri

Shfaqja e filmave në qiell të hapur do të kombinohet me servirjen e thjeshtë të birrës apo verës si edhe disa produkteve të thjeshta shoqëruese për klientët.

Kapitali i Nevojshëm: 200.000 – 300.000 Lekë

Vendi Ideal: Pika kyçe është vendi se ku do ta organizoni, dhe për këtë sugjerohen vende të larta sidomos taraca ndërtesash me fushëpamje pasi në këtë rast magjia e filmit të shfaqur natën në një ambient të hapur me yjet mbi kokë është impresionuese dhe elementi kryesor për suksesin e idesë.

Numri i Personave: 1 – 3 persona



6 UDHËTIM ME BIÇIKLETA NË ZONA RURALE

Sektori: Turizëm

Përshkrimi: Ideja e organizimit të udhëtimeve një ditore me biçikletë lindi si nevojë për të kaluar ditën ndryshe në qytete që ofrojnë pak mundësi argëtimi për vendasit por edhe për të huajt. Shumë prej qyteteve tonë rrethohen me zona rurale me natyrë shumë të bukur dhe lehtësisht të arritshme, pa përmendur këtu edhe pasuritë arkeologjike dhe historike që nuk mungojnë si edhe investimet e kohëve të fundit në infrastrukturë.

Të gjitha sa më lart mund të shfrytëzohen duke i përfshirë në paketën që do të ofroni. Kjo ide kërkon një investim të ulët dhe ekonomik por njëkohësisht kërkon angazhim dhe krijimtari në të vepruar.

Si funksionon: Të gjithë të interesuarit mbledhen në një pikë të caktuar të qytetit për tu transportuar (e përfshirë në çmim) drejt pikës ku fillon udhëtimi me biçikletë. Aty secili merr një biçikletë dhe nën drejtimin e një guide (të përfshirë në çmim) ndjek rrugët e ngushta rurale drejt destinacioneve dhe ndalesave të paracaktuara. Në këtë guidë mund të përfshihen vizita në shtëpi karakteristike, kantina vere, punishte të zonës që prodhojnë vaj apo produkte të tjera, stalla delesh apo lopësh, vende historike si kështjella apo rrënoja të ndryshme kishash, bukuri natyrore si lumenj e liqene, lokale dhe atraksione të tjera. Për të kompletuar udhëtimin mund të organizohen ndalesa të ndryshme si edhe një pushim dreke duke konsumuar ushqime të shpejta në natyrë ose duke organizuar një piknik.

Kapitali i Nevojshëm: 200,000 – 350,000 Lekë (min. 10 biçikleta, reklama)

Vendi Ideal: Zona rurale

Numri i Personave: 2 – 4 persona



7 ADAPTIMI I KONTENIERËVE NË SHTËPI BANIMI

Sektori: Ndërtim

Përshkrimi: Ideja e përdorimit të kontenierëve të vjetër dhe shndërimit të tyre në ambiente banimi mund të jetë një ide tërheqëse. Kjo ide po aplikohet më së shumti në Amerikë dhe Azi por edhe disa vende evropiane e kanë mirëpritur. Arkitektët modernë kanë gjetur tek kontenierët një mundësi shumë praktike për krijimin e akomodimeve me forma të ndryshme, brenda një kohe shumë të shkurtër dhe me kosto të ulët. Për më tepër këto ndërtime moderne mund të zhvendosen kollaj, nuk kërkojnë themele, leje ndërtimi dhe procedura të tjera si edhe janë struktura më e fortë ndaj tërmeteve dhe zjarrit..

Në varësi të buxhetit dhe vendit që dispononi mund të blini një, dy apo më shumë kontenierë të përdorur të madhësive të ndryshme. Pjesët anësore të kontenierëve mund të priten në forma të ndryshme (dyer, dritare) ose të hiqen totalisht për tu zevendësuar me sipërfaqe xhami. Skeleti i kontenierit na lejon shume hapësira në të gjitha anët. Të gjitha sipërfaqet e kontenierit të adaptuar mund të përforcohen me materiale izoluese dhe murale që e kthejnë atë në një shtëpi të vërtetë.

Ky aktivitet mund të fillohet në mënyrë të pavarur dhe artizanale dhe mundësia e krijimit të një biznesi të mirfilltë të vlerësohet në varësi të ecurisë.

Kapitali i Nevojshëm: 500,00 – 600,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona urbane dhe rurale

Numri i Personave: 3 – 5 persona



8 AMBIENT PIKNIKU ME QERA

Sektori: Turizëm, Argëtim, Shërbime

Përshkrimi: Është mundësia që pronën tuaj së bashku me natyrën e saj ta vini në përdorim me një investim minimal duke e shndërruar në ambient me qera për piknik në natyrë.

Qytetet e mëdha urbane por edhe shumë të tjera sot nuk ofrojnë shumë mundësi për zona ku mund të organizosh aktivitete në natyrë. Ndarja e tokës në parcela te vogla dhe shumë pronarë si edhe çmimet e larta të saj bëhen pengesë për inisiativa të tilla. Por kjo mund të jetë një ide e përkohëshme për ata që duan ti shesin tokat e tyre dhe nuk ja kanë arritur prej kohësh si edhe për ata që e shohin këtë ide si një mundësi afatgjatë dhe të vazhdueshme.

Nevojitet një rrethim i thjeshtë për sigurinë e pronës dhe të fëmijëve, complete druri me stola dhe tavolina, disa tenda të thjeshta, kosha mbeturinash, pak muzike në sfond sa për të filluar dhe një vend parkimi.

Më pas nëse e gjitha funksionon atëherë mund të shtoni edhe shërbime të tjera si ambient argëtimi për fëmijët, pishina plastike për fëmijët gjatë verës, një bar të vogël që ofron pije të ftohta dhe ndonjë ushqim të shpejtë e kështu me rradhë duke rritur edhe përfitimet tuaja për tokën e ofruar në këtë shërbim.

Kapitali i Nevojshëm: 200,000 – 300,000 Lekë (stola, tenda, kosha, etj)

Vendi Ideal: Zona rurale pranë zonave të banuara

Numri i Personave: 2 – 3 persona



9 TRAMPOLINA E KËRCIMIT

Sektori: Argëtim

Përshkrimi: Ideja e një trampoline për kërcim ka hyrë tashmë në shumë prej këndeve të lojrave në vendin tonë por kjo që ne ju ofrojmë është diçka më shumë.

Ne ju sugjerojmë trampolinën e madhe (e përbërë nga shumë trampolina të vogla) në formën e një piste sa një fushë basketbolli e rrethuar nga të gjitha anët. Kjo trampolinë mund të ndërtohet në ambient të mbyllur brenda të cilit të ofrohen edhe shërbime të tjera për klientët. Një sipërfaqe kaq e madhe dhe e mbuluar do të ishte një formë mjaft e këndëshme argëtimi për çdo moshë. Ajo do të ofronte mundësi si për fëmijët ashtu edhe për të rriturit të argëtoheshin duke kërcyer lart e për shumë persona kjo mund të kthehet edhe në sport. Prezenca e shumë trampolinave të lidhura së bashku e bën këtë eksperiencë të paharrueshme dhe të dëshirueshme për tu kthyer sërisht.

Ideja e biznesit synon gjenerimin e të ardhurave përmes një pagese për hyrjen në këtë ambient dhe përmes shërbimeve plotësuese të ofruara në këtë kompleks.

Kapitali i Nevojshëm: 200,000 – 400,000 Lekë (qeraja e ambientit, trampolina)

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i Personave: 1 – 3 persona



10 ORGANIZIMI I LOJËS “TOPA DJEGESI” NË MËNYRË PROFESIONALE

Sektori: Sportiv, Argëtim

Përshkrimi: Të gjithë i mbajmë mend lojrat e ndryshme që organizonin fëmijët përpara viteve 90-të kur mundësitë ishin të pakta. Një prej tyre dhe ndoshta më e famshmja që përfshin djem e vajza ishte “topa djegësi”. Por kjo nuk është vetëm një lojë Shqiptare. Sot në disa vende të botës kjo lojë është zhvilluar shumë dhe ka arritur të ketë edhe kampionatet e saj profesioniste.

Nëse dicka e tillë do të organizohej këtu do të kthente nostalgjinë e dikurshme dhe shumë të rinj do të kishin dëshirë të angazhoheshin aktivisht pasi është një lojë shumë lëvizëse që zhvillon fizikun dhe mendjen njëkohësisht. Kjo ide mund të fillojë me krijimin e një palestre ku të promovohet loja dhe më pas me zhvillimin e mini kampionateve mes skuadrave të strukturuar të grupeve shoqërore, shkollave e më tej. Gjithsesi për zhvillimin profesional të kësaj loje kërkohet plotësimi i disa elementeve teknik dhe të sigurisë të cilët do të garantojnë mbarëvajtjen e aktivitetit.

Me vazhdimin dhe zhvillimin e mëtejshëm mund të afrohen edhe sponsorizime të ndryshme të interesuara për të reklamuar dhe bashkëpunuar me ju në këtë fushë.

Kapitali i Nevojshëm: 150,000 – 250,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i Personave: 2 – 4 persona



11 MAKINA GOLFI PËR SHËTITJE

Sektori: Turizëm

Përshkrimi: Ambiente shlodhëse dhe me bukuri natyrore gjen shpesh në qytetet tona. Një nga këto mund të jetë edhe parku i liqenit i cili është një nga atraksionet e Tiranës në çdo stinë. Përveç qytetarëve që shëtisin apo aplikojnë aktivitetin sportiv në rrugët e këtij parku ka edhe shumë vizitorë vendas e të huaj që do të pëlqenin një vizitë ndryshe në këtë park. Ne ju ofrojmë idenë ekologjike të argëtimit dhe vizitës në këto ambiente me makineritë elektrike 8 vendëshe.

Këto makineri që zakonisht përdoren edhe për fushat e golfit në versionin dy vendësh do të ishin një zgjidhje ideale për të ofruar një shërbim të organizuar në rrugët e mirë organizuar disa kilometërshë të këtij parku. Gjithashtu duke e shoqëruar këtë udhëtim më një guidë shpejguese do ta kthente atë në një eksperiencë të këndëshme dhe relaksi për shumë persona.

Kostot për këtë ide janë të ulëta dhe kjo do të ofronte gjithashtu kosto të ulëta për vizitorët e këtij shërbimi. Mënyra ekologjike e transportit ruan ambientin dhe promovon këtë te çdo qytetar.

Kapitali i Nevojshëm: 350,000 Lekë (makina elektrike)

Vendi Ideal: Zona urbane, zona turistike

Numri i Personave: 1 – 2 persona



12 GRUP PASTRIMI PËR HEQJEN E POSTERAVE DHE GRAFITIT NGA MURET

Sektori: Shërbime

Përshkrimi: Një fenomen që vihet re në ditët e sotme është vendosja e posterave vend e pa vend në mure, shtylla apo xhama në çdo rrugë. Mund të jenë postera që reklamojnë politikanë apo këngëtarët pafund të klubeve të ndryshme. Ajo që kanë të përbashkët është vendosja pa kriter e shëmnia që i krijojnë qytetit. Për shumë pronarë biznesesh apo banesash kjo mund të përbëjë një shqetësim të madh dhe këtu mund të ndërhyhet me këtë ide inovative. Pastrimi i sipërfaqeve të dëmtuara nga ky aktivitet në mënyrë të organizuar nga një staf profesionist mund të jetë me interes për pronarët. Krahas pastrimit si pjesë e këtij shërbimi mund të ofrohet edhe merementim i ambienteve të dëmtuara si lyerje etj.

Kapitali i Nevojshëm: 100,000 – 150,000 Lekë (uniforma, mjete pune)

Vendi Ideal: Zona urbane, zona biznesi

Numri i Personave: 2 – 4 persona



13 KUAJ PONI ME QERA

Sektori: Turizëm, Argëtim

Përshkrimi: Kalërimi është diçka interesante për të rriturit por mund të jetë shumë i pëlqyeshëm edhe për fëmijët. Për këtë arsye mund të mendoni të merrni një apo dy kuaj të vegjël (Poni) dhe ti përdorni ata për të argëtuar fëmijët duke i bërë atyre xhiro ose për foto të ndryshme. E rëndësishme është edhe që vendi ku doni të organizoni këtë aktivitet të jetë i arritshëm nga personat e interesuar. Shëtitja me kuaj në vënde malore ose zona turistike mund të jetë një aktivitet zbavitës por edhe inovative për të rritur mirëqenien tuaj te jetesësë.

Kapitali i Nevojshëm: 200,000 – 350,000 Lekë (1 deri 2 poni si fillim)

Vendi Ideal: Zona urbane dhe rurale

Numri i Personave: 1 – 2 persona



14 AKTIVITETE ARGËTUESE PËR GRUPE


Sektori: Turizëm, Argëtim

Përshkrimi: Trevat Shqiptare ofrojnë mundësi pa fund për argëtimin e vizitorëve të ndryshëm. Nëse jeni person që pëlqeni të lëvizni dhe aventurën atëherë mund të konsideroni një biznes të tillë. Ajo që duam tju themi është se zonat ruarale janë akoma një fushë e paeksploruar për turizëm por që ofrojnë shumë më tepër se zonat urbane për sa i përket kulturës, traditës, historisë dhe dokeve. Së fundmi shumë prej këtyre zonave kanë pësuar ndryshime pozitive infrastrukturore por edhe kombinimi me infrastrukturën e amortizuar përbën interes për shumë vizitorë që rrallë i gjejnë këto ndërthurje në vendet ku jetojnë. Mënyrat e transportimit mund të jenë të ndryshme dhe atraktive në varësi të zonave si me mjete 4 x 4, me traktorë, me kafshe, më këmbë etj.

Kapitali i Nevojshëm: 300,000 – 500,000 Lekë (uniforma, veshje tradicionale, instrumenta muzikorë)

Vendi Ideal: Zona turistike në vënde urbane dhe rurale

Numri i Personave: 3 – 8 persona



15 SHËTITËS QENSH

Sektori: Shërbim

Përshkrimi: Dëshira në rritje e Shiptarëve për kafshët e sidomos për qentë së fundmi është rritur ndjeshëm duke kaluar cdo parashikim. Shumë prej tyre i duan ata edhe më shumë se vetë llojin e tyre. Por ajo që është për tu theksuar është se shumë prej këtyre kafshëve po mbahen në apartamente e kate të larta pallatesh gjë që bie ndesh me dëshirën e kafshëve për të qenë të lira, për të vrapuar dhe shijuar natyrën. Gjithashtu shumë njerëz megjithë dëshirën për të mbajtur kafshë në shtëpitë e tyre nuk kanë gjithmonë mundësi dhe kohën e duhur për ti shëtitur ato. Në këtë mënyrë ne ju sugjerojmë se nëse po kërkon një të ardhur shtesë ose një punë me kohë të pjesëshme, dhe padyshim nëse i doni kafshët të hidheni në idenë e shëtitësit të kafshëve të të tjerëve kundrejt një pagese. Ky aktivitet mund të zhvillohet çdo ditë në një kohë të caktuar ose sipas marrëveshjeve reciproke me pronarët e kafshëve.

Kapitali i Nevojshëm: 20,000 – 50,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i Personave: 1 person



16 MAKINA E AKULLORES SHËTITËSE

Sektori: Shërbime, Argëtim

Përshkrimi: Në ndryshim nga dyqanet e shumta të akulloreve që gjenden sot në qytetet tona kjo makineri është pak a shumë si karrocet e para viteve 90-të por e motorrizuar dhe tërheqëse sidomos për fëmijët. Në vend që të vijnë klientët tek ju shkoni ju tek klientët. Makina tërheq sidomos vogëlushët përmes një muzike shumë të këndshme lodrash dhe duke shkuar lagje me lagje apo oborre shkollash u tregon fëmijëve se akullorja është aty. Të gjithë mësojnë muzikën dhe ky kthehet në reflex të kushtëzuar duke mos iu përmbajtur tundimit.

Kjo ide biznesi përqëndrohet më shumë tek fëmijët pasi ata janë konsumatorët më të shumtë të akullores dhe duke e gërshetuar dhe me faktorin psikologjik ky mund të jetë një biznes jo vetëm fitim prurës por edhe argëtues.

Kapitali i Nevojshëm: 250,000 – 350,000 Lekë (makinë akullore e dorës së dytë, materiale)

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i Personave: 1 - 2 person



17 LAVANDERI NË DERËN E SHTËPISË


Sektori: Shërbime

Përshkrimi: Të ofroni shërbimin e lavanterisë në derën e klientëve tuaj është një ide e cila mund të funksionojë. Kjo mund të përshtatet me nevojat e sotme të klinetëve të cilët nuk kanë shumë kohë për të tilla shërbime. Zakonisht kjo po përdoret edhe në shërbime të tilla si larja e tapeteve dhe mund të ofrohet për familjarë por edhe për biznese. Ju mund të organizoni marrjen e rrobave në familje duke i dërguar ato më pas në lavaneri të profesionale.

Kapitali i Nevojshëm: 100,000 – 150,000 Lekë (uniforma, mjet i vogël, reklamim)

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i Personave: 2 - 4 persona



18 DHOMA E PASQYRAVE

Sektori: Argëtim

Përshkrimi: : Ka pasur dikur në Tiranë një dhomë me pasqyra. Ajo dhomë nuk është më por një ide e ngjashme ju vjen tani me krijimin e një dhome me pasqyra të çuditshme të cilat shtrembërojnë fytyrën dhe trupin e personit në shumë të shëndoshë, të hollë, të gjatë, të shkurtër, të shtypur etj, duke krijuar humor por nganjëherë edhe frikë. Kjo mund të jetë një ide e mirë për argëtimin e fëmijëve dhe të rinjve dhe kërkon një investim të ulët për të filluar.

Kapitali i Nevojshëm: 200,000 – 300,000 Lekë (ambjenti, pasqyrat, materiale)

Vendi Ideal: Zona urbane, turistike



19 MOBILJE ME MAKINA TË PËRDORURA

Sektori: Mobilim

Përshkrimi: Në rast se ju pëlqen e bukura dhe e veçanta kjo mund të jetë mundësia për ju. Mund të jeni profesionist në fushën e mobilerisë por jo domosdoshmërisht pasi mund ta realizoni këtë ide edhe duke përdorur shërbimet e përonave të tretë për montimin dhe finalizimin e produkteve.

Ideja nënkupton ndërthurjen e modeleve të makinave me mobiljet shtëpiake. Kjo për disa klientë mund të përbëjë një eksperiencë unike dhe dicka krejt të ndryshme dhe të personalizuar.

Për realizimin e idesë priten pjesë nga makinat e përdorura (më së shumti pjesa ballore e makinave) dhe përmes disa modifikimeve kthehen në koka krevati dhe mobilje të ndryshme sipas interesave apo porosive. Kështu klientët tuaj që mund të jenë familjar ose biznese (hotele) mund të kenë krevate mercedes, audi e kështu me rradhë.

Kapitali i Nevojshëm: 200,000 – 300,000 Lekë (makina të përdorura, mjete, ambjenti)

Vendi Ideal: Zona urbane, periferike

Numri i personave: 1 – 3 persona



20 REKLAMIM ME BIÇIKLETË TRE RROTËSHE

Sektori: Mobilim

Përshkrimi: Në rast se ju pëlqen e bukura dhe e veçanta kjo mund të jetë mundësia për ju. Mund të jeni profesionist në fushën e mobilitetit por jo domosdoshmërisht pasi mund ta realizoni këtë ide edhe duke përdorur shërbimet e personave të tretë për montimin dhe finalizimin e produkteve.

Ideja nënkupton ndërthurjen e modeleve të makinave me mobiljet shtëpiake. Kjo për disa klientë mund të përbëjë një eksperiencë unike dhe dicka krejt të ndryshme dhe të personalizuar.

Për realizimin e idesë priten pjesë nga makinat e përdorura (më së shumti pjesa ballore e makinave) dhe përmes disa modifikimeve kthehen në koka krevati dhe mobilje të ndryshme sipas interesave apo porosive. Kështu klientët tuaj që mund të jenë familjar ose biznese (hotele) mund të kenë krevate mercedes, audi e kështu me rradhë.

Kapitali i Nevojshëm: 200,000 – 300,000 Lekë (makina të përdorura, mjete, ambjenti)

Vendi Ideal: Zona urbane, periferike

Numri i personave: 1 – 3 persona



21 LOGJISTIK NË FAMILJE

Sektori: Shërbime

Përshkrimi: Nëse jeni i ri dhe pa ndonjë aftësi të veçantë profesionale por po kërkon një punë të pjesëshme për të fituar pak para, kjo mund të jetë mundësia juaj. Në ditët e sotme shumë familje dhe biznese kanë mundësi ekonomike të rrisin standartet e tyre të jetesës por nuk kanë shumë kohë në dispozicion për të plotësuar nevojat dhe shërbimet e tyre. Këtu mund të jetë mundësia që ju të përfshiheni për të ofruar këtyre familjeve ose subjekteve disa nga shërbimet e mëposhtme:

Transport i pazareve të përditshme nga dyqani apo makina në shtëpi
Blerje të ndryshme
Shërbime postare
Pagesa faturash mujore
Blerja e gazetës
Kujdesi për kafshët shtëpiake
etj.

Kapitali i Nevojshëm: 20,000 – 40,000 Lekë (lajmërimet, reklamim për shërbimet)

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i personave: 1 person



22 ANIMATOR OSE VIZATIM FYTYRASH PËR FËMIJËT

Sektori: Argëtim

Përshkrimi: Kjo ide mund të plotësojë dëshirën tuaj për të pasur një punë argëtuese me fëmijët. Për këtë mund të organizoheni me dy apo tre miq dhe të krijoni një grup i cili do të ofrojë shërbime animimi dhe organizimi gjatë festave dhe ditëlindjeve të fëmijëve. Nëse jetoni në një qytet ku ky shërbim nuk ofrohet atëherë shanset për të qenë të suksesshëm janë më të mëdha. Kjo ide mund të fillojë me një investim të ulët për pajisjen me mjete të ndryshme si kostume me figurat e dashura për fëmijë, lojra formuese dhe bojra për vizatimin e fytyrave të fëmijëve gjatë festës. Pa dyshim që për të qënë sa më konkurrues në treg duhet një trajnim paraprak lidhur me komunikimin, mënyrat e organizimit të lojrave, muzikës etj.

Kapitali i Nevojshëm: 100,000 – 200,000 Lekë (materiale, uniforma)

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i personave: 2 – 4 persona



23 FERMA E FËMIJËVE

Sektori: Argëtim

Përshkrimi: Shumë fëmijë po rriten sot në qytete dhe ambiente të mbyllura. Ata janë shumë larg zonave rurale dhe jetës së fshatit duke pasur një njohje jo shumë të madhe të këtij realiteti dhe më konkretisht me kafshët shtëpiake. Shumë prej tyre ata i njohin vetëm nga librat kështu që organizimi i një aktiviteti të tillë si Ferma e Fëmijëve do të jetë shumë interesant për fëmijët dhe i mirëpritur nga prindërit. Një fermë e tillë mund të ndërtohet në një vend jashtë qyteteve por edhe afër tyre dhe në vende të arritshme nga njerëzit. Ajo do të funksiononte si një kopësht zoologjik me shpendë dhe kafshë të buta shtëpiake dhe të fermës të organizuara në departmanente. Midis ndarjeve mund të ndërtohet një sistem rrugësh të vogla i cili do të ndihmojë fëmijët tu afrohen kafshëve, ti prekin, të luajnë me ta e të bëjnë foto. Gjithashtu sugjerohet që ferma të ofrojë edhe informacion dhe shpjegime mbi secilën kafshë në formën e të mësuarit por edhe informacione të ndryshme mbi bimët dhe mënyrat si kultivohen drurë të ndryshëm.

Sektorit të mësipërm mund ti shtohen edhe elementë argëtues dhe shërbimi si hapësira për piknik, një bar dhe fast food, lodra dhe ambiente argëtuese etj.

Kapitali i Nevojshëm: 500,000 – 600,000 Lekë (vendi me qera, infrastrukturë e thjeshtë, kafshët)

Vendi Ideal: Zona rurale pranë zonave të banuara

Numri i personave: 2 – 5 persona



24 RIKIKLIMI I VAJIT TË GATIMIT

Sektori: Industri, Riciklim

Përshkrimi: Nëse po shikoni për të hapur një biznes të vogël që do tju lejojë të keni përveç përfitimit edhe një impakt të madh në ambient duhet të filloni një biznes të filtrimit të vajit të gatimit. Ka me mijëra "fast food" në Shqipëri por edhe në rajon të cilat përdorin vaj gatimi për patatat e skuqura dhe produkte të tjera të skuqura. Po ti shtosh edhe numrin e madh të restorantëve dhe familjeve që përdorin vajin për skuqje kemi një çështje shumë të madhe mjedisore në momentin kur i gjithë ky vaj kthehet në mbeturinë. Ju mund ta mblidhni vajin e përdorur nga familjarët apo subjektet tregëtare me një çmim shumë simbolik (duke pasur parasysh që ai do të derdhet ose hidhet) dhe përmes një makinerie ta ricikloni dhe ta ktheni atë në një produkt të përdorshëm përsëri. Kjo do tju jepte avantazhin e çmimit dhe të prodhimit me kosto të ulët brenda vendit pa kosto transporti dhe dogane. Ky produkt mund të përdoret shumë nga një shtresë e shoqërisë e cila nuk mund të përballojë çmimet e larta ose edhe nga një pjesë e industrisë së ushqimit. Për ta filluar do tju duhet makineria e riciklimit, një vend dhe pak fond për ta promovuar aktivitetin. Sapo të krijoni klientët e parë do të keni kërkesat e tjera pasi ky aktivitet funksionon përmes komunkimit.

Kapitali i Nevojshëm: 450,000 Lekë (pajisje)

Vendi Ideal: Zona rurale pranë zonave të banuara

Numri i personave: 2 – 4 persona



25 TË BËHESH BLETËRRITËS

Sektori: Agrobiznes

Përshkrimi: Nëse po shikoni për një aktivitet jo shumë të zakonshëm që mund të prodhojë një produkt të ëmbël dhe fitimprurës, atëherë duhet të konsideroni si të bëheni bletërritës. Nëse nuk keni punuar kurrë me bletët më parë, ky është një zanat i thjeshtë. Disa mjete që ju duhen janë veshje special, një mjet për të hapur kosheren, dhe një kuti tymi. Tym i qetëson bletët dhe ju ndihmon në momentet që do të hapni kosheren.

Në momentin që keni marrë bletët dhe ato po bëjnë mjalt të lumtura, detyra juaj do të jetë të ruani dhe të siguroheni që asnjë bletë mos të duket e sëmurë dhe që mbretëresha nuk po hedh vezë. Shpejt ju do të keni një sasi mjalti të cilin mund ta shisni tek dyqanet e zonës. Produkte të tjera që mund të shisni nga kjo punë mund të jenë dylli, hojet, qumështi etj. Nëse kujedeseni mirë për to, bletët mund të jenë të kënaqura duke prodhuar mjaltin dhe duke bërë një fitim për ju.

Kapitali i Nevojshëm: 150,000 – 200,000 Lekë (terreni, bletët, infrastruktura)

Vendi Ideal: Zona rurale

Numri i personave: 1 – 2 persona

POSTER



26 REKLAMA NË TUALET

Sektori: Reklamim

Përshkrimi: Reklamimi në ditët e sotme ka kaluar çdo parashikim dhe shumë besojnë që nuk nuk ka më vend pa u përdorur për reklamë por risitë janë gjithmonë të pranishme. A ju ka shkuar në mendje se mund të reklamohet në disa vende të çuditshme por ku reklamimi mund të jetë shumë i suksesshëm në sensin që të lexohet nga më shumë persona. Një ide mund të jetë pra reklamimi në tualetet e bareve dhe restoranteve. Në ato pak minuta intime gjithkush do ta ketë vëmendjen tek ajo që shkruhet përballë dhe kjo mund të jetë një ide efikase por dhe jo shumë e kushtueshme për bizneset që duan të reklamojnë përmes idesë tuaj.

Kapitali i Nevojshëm: 150,000 – 200,000 Lekë (materiale promovuese)

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i personave: 2 – 3 persona



27 REKLAMA ÇANTË SHPINE

Sektori: Reklamim


Përshkrimi: Mjetet e reklamimit sot kanë marrë një zhvillim të vullshëm dhe po kthejnë çdo gjë në funksion të komercialitetit por ideja në vazhdim mund tju fusë në mendime dhe tju shtyjë që ta provoni vetë atë. Kjo ide nuk ka nevojë për aftësi të mëdha apo shpenzime të larta për të krijuar shërbimin. Bëhet fjalë për një mjet reklamimi të lëvizshëm që përdor personat për të promovuar reklamën në vende që është vështirë për shumë mjete të tjera reklamimi që të futen. Pra më konkretisht bëhet fjalë për reklamimin “çantë shpine”. Nëse jeni një grup shokësh ose një person me aftësi të mira organizative mund të provoni të vishni uniforma dhe të hidhni në krah reklamën përkatëse duke lëvizur pa fund kudo në lokale, shkolla, lagje, tregje, rrugë e të tjera. Vende këto ku vështirë të futen stenda reklamuese apo mjete të lëvizëshme. Efekti tjetër pozitiv i kësaj ideje është kosto e ulët e shërbimit që sjell mundësi të mira fitimi për personat që duan të zhvillojnë këtë shërbim por edhe për bizneset që duan të reklamojnë. Përdorimi i personave për reklama të lëvizëshme mund të shoqërohet edhe me informim shtesë nga këta persona të cilët mund të trajnohen për produktet ose me fletëpalosje dhe materiale të tjera promovuese.

Si në rastet e mëparëshme thelbi i fillimit të suksesshëm qëndron tek ngritja e rrejtit dhe promovimi i shërbimit me kosto të ulët tek bizneset. Kjo ide mund të jetë e përshtatëshme edhe për përfshirjen e kategorive të cënuara dhe për ngritjen e mundësive të punësimit për këto kategori.

Kapitali i Nevojshëm: 200,000 – 300,000 Lekë (stendat e reklamave, materiale promovuese)

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i personave: 4 – 6 persona



28 PIKTURA 3D NË TROTUAR

Sektori: Art, Argëtim

Përshkrimi: Jeni i apasionuar pas grafitit dhe artit por nuk dini si ta ktheni atë në biznes dhe përfitim? Kjo ide gjeniale ju vjen në ndihmë. Në ndryshim nga ajo që personat që merren me grafitin bëjnë duke praktikuar atë në vende publike kjo është një ide që kërkon një vend paksa privat për tu aplikuar. Sugjerohet të identifikohet një vend i rrahur nga njerëzit dhe sidomos nga turistët pranë shesheve ose rrugëve kryesore. Në momentin që keni në dispozicion një vend të tillë atëherë ide është që të krijoni një pamje me grafit e cila duhet të jetë në versionin 3D për tu kthyer në atraksion. Më pas variantet vizatohen në tokë (jo në mure) dhe janë zakonisht pamje që ngjallin frikë dhe panik dhe në jetën reale janë të paperceptueshme. Këto pamje si psh: çarja e tokës, ose një copë oqeani me një peshkaqen në mes të rrugës etj, mund të jenë një mundësi fantastike për të bërë fotografi për të gjithë dhe për të pasur një kujtim të veçantë nga ai vend. Kjo mund të jetë një mundësi e mirë edhe për artistin që të fitojë disa të ardhura për artin e tij.

Kapitali i Nevojshëm: 150,000 – 200,000 Lekë (vendi, bojë speciale grafiti, materiale promovuese)

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i personave: 1 person



29 KËNDI I SHTRYDHJES SË FRUTAVE

Sektori: Shërbime

Përshkrimi: Lëngjet e frutave pëlqehen sot nga çdo grupmoshë ndërkohë që shumë kompani janë hedhur në treg me produkte të shumta që ofrojnë çmime dhe cilësi të ndryshme. Por të gjithë biem dakord që lëngu i përftuar nga shtrydhja e frutave origjinale është më cilësor. Ideja konsiston në krijimin e një qoshe ose këndi në një rrugë të populluar ku të shërbehet lëng origjinal frutash të ndryshme duke i shtrydhur në sy të klientit sipas dëshirës dhe porosisë. Mjetet shtrydhëse mund të jenë të mekanizuara ose të thjeshta të punuara me dorë. Ne do të këshillojmë variantin e dytë pasi jep më shumë origjinalitet në të gjithë këtë ide. Sfondi i dyqanit shërben edhe si magazinë me arka ku mbahen frutat e ndryshme dhe klientëve u ofrohen shishe plastike të madhësive të ndryshme nga të cilat ata mund të zgjedhin.

Çfarë kërkohet:

- Vend me qera në një vend të dukshëm dhe të populluar
- 3 ose 4 shtrydhëse frutash
- Paketim (shishe plastike uji të madhësive të ndryshme)
- Furnizim me fruta të llojeve të ndryshme (të shtrydhëshme)

Kapitali i Nevojshëm: 250,000 – 350,000 Lekë (ambjent me qera, shtrydhëse, mall për të filluar punën, reklamim)

Vendi Ideal: Zona urbane, zona turistike

Numri i personave: 2 - 4 person



30 MINILOKALI

Sektori: Shërbime

Përshkrimi: Ata që kanë udhëtuar në vendet e lindjes sidomos mund të kenë vizituar lagje të ndryshme të qyteteve ku çdo sipërfaqe është shfrytëzuar për ti dhënë gjallëri dhe për të krijuar ambiente të ndryshme shlodhje dhe memorie historike. Ideja në fjalë na flet për mini lokal ose kafeteri ku klientët ulen në ministola dhe shijojnë çaj ose kafe turke në minitavolina ose shpehsherë duke i mbajtur filxhanët në dorë. Nëse zotëroni apo doni të merrni me qera një ambient të vogël sipas mundësive mund të konsideroni ta ktheni në një minilokal të tillë atraktiv jo vetëm për të apasionuarit e stilit të vjetër por edhe për turistët. Megjithëse një praktikë e vendeve orientale më së shumti kjo mund të kthehet edhe në një ide të përshtatur për disa zona të qytetit tuaj. Shijimi i një kafe apo çaji në këto kushte duke pasur parasysh nivelin e lartë të luksit në lokalet e sotme do ta kthente këdo prapa në kohë.

Mjetet:

- o Stola të vegjël druri
- o Tavolina të vogla druri që palosen
- o Mjete të nevojshme për prodhimin e çajit të malit dhe kafes turke

Vendi Ideal: Zona urbane , zona turistike, rurale. Ambient i vogël me qera në qoshe të dukshem ose pranë rrugëve kryesore.



31 KULTIVIMI I KËRMILLIT

Sektori: Agrobiznes

Përshkrimi: Nëse nuk e dini që edhe kjo mundësi ekziston mund të jetë fillimi i një ideje me vlera. Kërmilli ka proteina me vlera të larta biologjike dhe një përmbajtje modeste yndyre prej 1.7 përqind dhe të ushqyerit me këtë mish favorizon eliminimin e kolesterolit nga organizmi dhe ndihmon në sëmundjet e personave të moshuar në rastet e anemisë dhe në gjendjet e rënuara shëndetsore dhe sidomos në sëmundjet e stomakut. Është ushqim energjik për personat që ushtrojnë aktivitete sportive dhe punë të lodhshme fizike. Rekomandohet veçanërisht për personat me yndyrna të larta në gjak dhe është e mira që të konsumohet të paktën dy herë në javë. Metodat e gatimit janë nga më të ndryshmet si tavë në furrë, me pilaf, makarona dhe sidomos supë. Guzhina italiane dhe franceze është shumë e larmishme me produktet e kërmillit.

Disa kompani perfaqësuese ekskluzive për Shqipërinë të kompanive franceze dhe Italiane ofrojnë teknologjinë e rritjes së kërmillit bio, rasat kermilli të përzgjedhur, materiale ndihmëse si dhe kontrata afatgjata për blerjen e prodhimit.

Kapitali i Nevojshëm: 500,000 Lekë (blerje rasati, rrethim)

Vendi Ideal: Siperfaqja minimale e këshilluar: 1 ha, fushë ose kodër, e vaditshme

Numri i personave: 2 persona



32 MUZEU “PUNIME DORE”

Sektori: Turizëm

Përshkrimi: NTë gjithë e njohim punimin me vegjë si një formë tradicionale e vendit tonë. Pa dyshim që ka qenë shumë e vështirë ruajtja e traditës dhe e punës me këto vegla e mjete të vjetra dhe sot pak e përdorin si formë të lodhshme dhe të shtrenjtë. Por kjo është një mënyrë që mund të përdoret jo vetëm për prodhimin direkt të sixhadeve apo artikujve të tjerë tradicional por edhe për atraksionin dhe bukurinë që ofron procesi i endjes. Shumë prej agjensive që merren me paketat turistike për të huajt në Shqipëri do të donin të lidhnin kontrata bashkëpunimi me ju në rast se ju do të dispononit një ambient ku punohet me vegjë. Turistët kanë dëshirë dhe kureshtje të shikojnë se si është punuar në kohët e vjetra dhe se si janë ruajtur me fanatizëm doket dhe tradita e vedndit. Në këtë rast përveç produktit që mund të shisni, vegja juaj mund të kthehet edhe në një museum ku njerëz të shumtë mund të paguajnë për tju vizituar. Kjo ide përshtatet më së miri për gratë të cilat janë shtëpiake dhe kanë pasion këtë teknikë të punimeve me dorë.

Çfarë nevojitet?

- Një sipërfaqe mesatare jo detyrimisht në qendër të qytetit dhe kate të para
- Një vegjë e përmasave normale
- Materiale pune
- Kontakte me agjensi turistike
- Fletëpalsoje

Kapitali i Nevojshëm: 500,000 – 600,000 Lekë (pajisje, materiale)

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i personave: 3 – 5 persona



33 BIÇIKLETA E BIRRËS

Sektori: Argëtim

Përshkrimi: Nevoja për më shumë hapësira në ditët e sotme sa vjen dhe rritet ndërkohë që hapësirat reale të vendeve ku punojmë dhe jetojmë sa vijmë dhe tkurren duke e bërë shpeshherë të vështirë bashkëjetesën me orënditë, objektet personale dhe mallra të tjera të cilat nuk duam ti hedhim por nuk kemi as vend se ku ti mbajmë. Për këtë ju sjellim idenë e Depos me Qera.

Kjo ide mund ti përshtatet shumë mirë qyteteteve të mëdha dhe mundësive të shumë personave të cilët janë në kërkim të një ideje të re biznesi.

Depo me Qera përbëhet nga një hapësirë e madhe (kapanon) i cili ndahet në hapësira më të vogla përmes ndarjeve portative dhe shërben për vendosjen dhe ruajtjen e sendeve apo orëndive me volum të madh por që nuk janë objekt i sigurisë së lartë. Këtu mund të vendosen orëndi shtëpiake të përdorura, orëndi zyre, sende të ndryshme që duam ti ruajme, mjete të ndryshme transporti (biçikleta, motorrë), pajisje elektronike apo shtëpiake e shumë të tjera. Lëshimi i ambienteve me qera kohore të ndryshme sipas sipërfaqeve përbën edhe sensin e këtij biznesi. Depoja kërkon edhe sistem ruajtje në forma të ndryshme për të garantuar mallin dhe mund ti bashkëngjiten edhe shërbime të tjera si psh ai i transportit.

Kapitali i Nevojshëm: 500,000 – 600,000 Lekë (ambjent me qera, stenda, materiale promovuese)

Vendi Ideal: Zona urbane periferike

Numri i personave: : 3 – 4 persona



34 SANDUIÇ ME VEZË

Sektori: Ushqim

Përshkrimi: Një ide sa e thjeshtë aq edhe tradicionale. Për arsye të kostos së lirë dhe proteinave të larta vendosëm që të vendosim këtë ide në listën tonë të ideve të biznesit. Të interesuarit mund të përfshijnë këtë produkt në bizneset e tyre aktuale ose të planifikojnë ta organizojnë këtë aktivitet si një ide fillestare me kosto të ulët. Ky produkt ofron çmim ekonomik për të gjithë ata që konsumojnë ushqim jashtë por që nuk duan të shpenzojnë shumë para. Kjo ide mund të funksionojë edhe si shërbim ambulant

Kapitali i Nevojshëm: 50,000 – 100,000 Lekë (mjete, materiale)

Vendi Ideal: Zona urbane të populluara.

Numri i personave: 1 persone



35 TUALETE PORTATIVE TË LËVIZSHËM

Sektori: Shërbime

Përshkrimi: Nevoja për tualete publike në qytetet tona është një fenomen i përgjithshëm dhe prezent në shumë zona dhe prej shumë kohësh. Pa dyshim që jeni njohur me tualetet e lëvizshme të cilat jo rrallë gjenden në ambiente private por nevoja për ti vendosur ato në ambiente publike mund të përbëjë një ide për të filluar një aktivitet fitimprurës në këtë fushë. Nëse ndërtoni një strategji të tillë paraqiteni atë tek organet vendore për zona si qendra qyteti, plazhe apo parqe dhe shanset mund të jenë të mira për të marrë një leje përkatëse për këtë. Ky shërbim shkon në linjë edhe me faktorët ambientalist dhe do të ishte një vlerë e shtuar për komunitetet tona. Nëse bëheni pronar i dy apo tre tualeteve dhe i vendosni ato sipas miratimit në ambiente publike duhet të kujdeseni më së shumti për elementin higjenë dhe ti mbani ato sa më pastër pasi kjo do ta bënte biznesin tuaj të suskesshëm.

Kapitali i Nevojshëm: 200,000 – 300,000 Lekë (tualetet e lëvizshme)

Vendi Ideal: Zona urbane, zona turistike, plazhe etj.

Numri i personave: 1 – 2 persona



36 STENDË PER FOTO ME KOKA BOSH

Sektori: Argëtim

Përshkrimi: Shumë turistë që vizitojnë vendet më të bukuar tonat duan të kenë kujtime nga këto vende duke fotografuar momente të veçanta. Pa dyshim që në vendin tonë ka panorama dhe pjesë shumë të veçanta për tu pasur si kujtime por një mundësi shumë praktike dhe origjinale mund ta ofrojë ideja e fotografimit në stendën e gatshme dhe të lëvizëshme.

Kjo stendë ka një veçori e cila është hapësira boshë në vendet e kokave të njerzve duke i dhënë mundësi secilit individ të vendosë veten në të dhe ta personalizojë fotografinë. Stendat mund të kenë të vizatuara ose të fotografuara persona të veshur me veshje tradicioanle të zonave të ndryshme, veshje plazhi, veshje të profesionave të ndryshme, personazhe të kohëve të kaluara të lidhura me historinë ose me traditën, personazhe për fëmijët nga filmat vizatimorë ose përrallat, personazhe të vendosur në mjete të ndryshme e shumë të tjera sipas fantazisë për ti bërë ato sa më tërheqëse ose humoristike. Këto stenda mund të vendosen në pika kyç ku kalojnë turistë ose në parqe e bulevarde ku shëtisin njerëz. Ju mund të ofroni fotografinë ose të lejoni personat të bëjnë foto me aparatet e tyre kundrejt një pagese simbolike e cila në fund të ditës mund të rezultojë e suksesshme.

Kapitali i Nevojshëm: 100,000 Lekë (përgatitja e stendës)

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i personave: 1 person



37 FURRA DIELLORE

Sektori: Argëtim

Përshkrimi: Kjo ide inovative i shërben komuniteteve në nevojë dhe atyre me të ardhura të pakta. Është një ide që përdor faktorët natyral për shërbime familjare apo të jetës së përditëshme duke kursyer energji e cila është shumë e kushtueshme në ditët e sotme. Ideja ka të bëjë me ndërtimin e disa pajisjeve me mjete të thjeshta dhe me përbërje druri të cilat funksionojnë si furra pjekje për gatimet e përditshme përmes energjisë diellore e cila gjendet me shumicë në vendin tonë. Këto pajisje inovative kanë qenë shumë të suksesshme në vende të botës së tretë dhe përdoren nga shumë komunitete atje.


Ena me gatimin e zakonshëm vendoset brenda pajisjes prej druri dhe mbyllet me një kapak me xham të veçantë. Rrezet e diellit kalojnë përmes xhamit special dhe nën efektin e nxehtësisë gatimi arrijnë temperatura që arrihen zakonisht përmes furrave me korrent dhe me gaz. Kështu do të kemi vakte të përditëshme pa pasur nevojë për të shpenzuar energji elektrike. Gatimi në furrë mund të jetë një nga shpenzimet e një familje sot por nëse e kursejmë atë arrijmë të sigurojmë një të ardhur shtesë duke ulur faturat e korrentit dhe gazit.

Të gjithë të interesuarit mund ta konsiderojnë këtë si aktivitet fitimprurës dhe duke krijuar një skuadër me punues druri mund të ndërtojnë këto pajisje dhe tua ofrojnë ato për shitje të interesuarve.

Kapitali i Nevojshëm: 250,000 – 300,000 Lekë (ambjenti, pajisje, vegla, materiale)

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i personave: : 3 – 5 persona



38 MAGAZINA (DEPO) ME QERA SIPAS HAPËSIRËS

Sektori: Argëtim

Përshkrimi: Nevoja për më shumë hapësira në ditët e sotme sa vjen dhe rritet ndërkohë që hapësirat reale të vendeve ku punojmë dhe jetojmë sa vijmë dhe tkurren duke e bërë shpeshherë të vështirë bashkëjetesën me orenditë, objektet personale dhe mallra të tjera të cilat nuk duam ti hedhim por nuk kemi as vend se ku ti mbajmë. Për këtë ju sjellim idenë e Depos me Qera.

Kjo ide mund ti përshtatet shumë mirë qyteteteve të mëdha dhe mundësive të shumë personave të cilët janë në kërkim të një ideje të re biznesi.

Depo me Qera përbëhet nga një hapësirë e madhe (kapanon) i cili ndahet në hapësira më të vogla përmes ndarjeve portative dhe shërben për vendosjen dhe ruajtjen e sendeve apo orendive me volum të madh por që nuk janë objekt i sigurisë së lartë. Këtu mund të vendosen orendi shtëpiake të përdorura, orendi zyre, sende të ndryshme që duam ti ruajme, mjete të ndryshme transporti (biçikleta, motorrë), pajisje elektronike apo shtëpiake e shumë të tjera. Lëshimi i ambienteve me qera kohore të ndryshme sipas sipërfaqeve përbën edhe sensin e këtij biznesi. Depoja kërkon edhe sistem ruajtje në forma të ndryshme për të garantuar mallin dhe mund ti bashkëngjiten edhe shërbime të tjera si psh ai i transportit.

Kapitali i Nevojshëm: 500,000 – 600,000 Lekë (ambjent me qera, stenda, materiale promovuese)

Vendi Ideal: Zona urbane periferike

Numri i personave: : 3 – 4 persona



39 VIZATIM MAKINASH

Sektori: Art

Përshkrimi: Nëse jeni i apasionuar pas makinave dhe pikturës në të njëjtën kohë mund të praktikoni këtë aktivitet të kombinuar për të kënaqur të apasionuarit e tjerë duke shndërruar makinat e tyre në art. Në telajon e makinave mund të vizatohen objekte të ndryshme sipas imagjinatës ose katalogut duke ofruar kështu mundësinë për një makinë unike dhe të veçantë.

Ideja për të ndërtuar një biznes të tillë mund të iniciohet përmes një aktiviteti të thjeshtë me një numër të kufizuar modelesh dhe ngjyrash duke kaluar disa hapa për zhvillimin e mëtejshëm në varësi të ecurisë.

Për këtë do të nevojitet një vend jo domosdoshmërisht në qendër të qytetit dhe disa mjete për të filluar punën tuaj. Ose mund të bashkëngjiteni pranë një servisi ekzistues dhe të ofroni shërbimin tuaj sipas porosive.

Kapitali i Nevojshëm: 150,000 Lekë (pajisje për vizatim makinash, mjete të ndryshme, bojëra etj)

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i personave: 1 person



40 TATUAZH

Sektori: Art

Përshkrimi: Ideja për të zhvilluar një biznes tatuazhi mund të duket diçka shumë e thjeshtë por për personat që kanë dhunti dhe pasion këtë aktivitet kjo mund të shndërrohet në një mundësi përfitimi sezonal ose gjatë gjithë vitit. Zhvillimi i këtij aktiviteti varet nga mënyra se si ai praktikohet, stabil dhe i përqendruar apo lëvizës duke afruar shërbimin pranë klientëve, tatuazh i përhershëm apo i përkohshëm sipas rasteve.

Tatuazhi në ditët e sotme pëlqehet dhe përdoret shumë nga të rinj dhe grupmoshave të tjera kështu që nevoja për të ofruar këtë shërbim mund të jetë gjithmonë e pranishme. Për të filluar këtë ide mund tju nevojiten disa pajisje dhe një vend i vogël ose stendë lëvizëse në rastin e idesë së lëvizëshme. Mos harroni që higjiena dhe siguria për pastërtinë gjatë procesit janë thelbi i kësaj ideje.

Kapitali i Nevojshëm: 150,000 – 250,000 Lekë (mjete për tatuazhe në varësi të aktivitetit)

Vendi Ideal: Zona urbane të populluara

Numri i personave: 1 person



41 TEATËR FËMIJËSH I LËVIZSHËM

Sektori: Argëtim, Art

Përshkrimi: Nevoja për argëtim e fëmijëve është e madhe në ditët e sotme ku hapësirat publike dhe shërbimet e ofruar janë të pakta dhe lënë për të dëshiruar. Nga ana tjetër të gjithë prindërit do të paguanin për të argëtuar fëmijët e tyre dhe për të kaluar disa momente relaksi gjatë kohës që fëmijët janë në aktivitet. Për këtë ne sjellim idenë e një teatri fëmijësh lëvizës për grupmosha të ndryshme. Në vend që të vijnë fëmijët tek ju mund të shkoni ju tek ata duke organizuar shfaqje dhe aktivitete në institucione, shkolla, zona banimi, parqe, plazhe etj. Shfaqet mund të jenë të natyrave të ndryshme nga ato me kukulla të vogla deri tek ato me personazhe reale dhe maskota. Për këtë padyshim do tju nevojiten aftësi teatrale, një grup miqsh me të njëjtat karakteristika dhe eksperiencë si edhe një mini skenë dhe veshje. Ideja e teatrit aktiv mund të shoqërojë këtë aktivitet duke përfshirë edhe fëmijët në shfaqje e duke luajtur role me ta.

Kapitali i Nevojshëm: 300,000 Lekë (skenë e lëvizëshme, veshje, uniforma, materiale skene)

Vendi Ideal: Zona urbane dhe rurale

Numri i personave: 3 – 5 persona



42 DRURI QË RRIETET SHPEJT

Sektori: Agrobiznes

Përshkrimi: : I njohur si druri me rritjen më të shpejtë në bote (20 metra në 3 vjet) dhe me cilësitë më të mira në krahasim me çdo dru tjetër. Kjo ide fantastike biznesi ju vjen përmes këtij botimi për tjuar kthyer kapitalin tuaj fizik, në këtë rast toka, në një burim të sigurtë të ardhurash. Në rast se dispononi një sipërfaqe prej minimumi 1 Ha atëherë ky është një biznes shumë i leverdisshëm për ju. Me një investim prej 5000 eurosh ju mund të keni një avantazh të madh ndaj të tjerëve përmes kultivimit të drurit që rritet shpejt i cili zhvillohet me përmasa gjigande deri në 20 metra në tre vjet. Duke shtuar edhe cilësinë e këtij produkti ju mund të krijoni parcelat tuaja të parave dhe ti shtoni ato në një kohë shumë të shkurtër. Ky produkt i ri hyn në Shqipëri me asistencë teknike dhe të gjithë elementët e nevojshëm për të filluar direkt nga puna. Ky dru mund të jetë gjithashtu shumë i volitshëm edhe për të gjitha ata persona që duan të krijojnë hapësira të gjelbërta për vilat apo lokalet e tyre me ritme të shpejta. Ka investim minimal, dedikim të kufizuar në kohë krahasuar me çdo produkt tjetër bujqësor, kosto të ulëta në fuqi punëtore për krasitje, e shumë favorizime të tjera.

Kapitali i Nevojshëm: 650,000 Lekë (vlera e nevojshme për të mbjellë fidanët)

Vendi Ideal: Zona rurale



43 SHËRBIM ZHVENDOSJE

Sektori: Shërbime

Përshkrimi: Zhvillimi i qyteteve tona sjell me vete edhe nevojat për shërbime te ndryshme. Sot popullsia lëviz nga zonat rurale drejt metropolove por ka lëvizje të shumta edhe brenda metropoleve. Kjo mund të jetë një ide e mirë për dikë që të fillojë një biznes transporti dhe rilokimi / zhvendosje si shërbim për personat e interesuar. Lëvizje nga katet e larta, ngarkim në të dy drejtimet lart poshtë, transport i pajisjeve apo mobiljeve me makinë, shërbim i mbajtjes së pajisjeve apo mobiljeve për një kohë të shkurtër, shërbim i kujdesit për pajisjet me vlerë ose të thyeshme etj, mund të jenë disa nga mundësitë që mund të ofrojë kjo ide. Nevoja të tilla ka shumë, ndërkohë që çmimi, cilësia dhe korrektesa janë armët e forta të këtij biznesi.

Kosto e lirë e krahut të punës dhe numri i lartë i papunësisë në vend mund tju ndihmojë gjithashtu për të krijuar një staf fillestar. Mënyrat elektronike mund të shërbejnë në fillim për promovimin e shërbimit derisa ju të kënaqni klientët e parë e fjala të përhapet.

Kapitali i Nevojshëm: 200,000 – 350,000 Lekë (mjet transporti, uniforma, materiale promovuese)

Vendi Ideal: Zona urbane


Numri i personave: 2 – 3 persona



Sektori: Ushqim

Përshkrimi: : Imagjinoni të hani një nga personat VIP të politikës apo artit. Kjo mund të jetë e vërtetë nëse hapni një piceri e cila të shërbejë pica me emrat e politikanëve apo aktorëve. Në këtë rast dyqani apo restoranti juaj i vogël do të bëhet shumë i njohur dhe njerëz nga çdo anë do të vijnë aty për të porositur, shijuar dhe ngrënë një pica "Berisha" apo pica "Rama", një pica "Bred Pit" apo "Angelina Jolie". Një ide kaq e thjeshtë mund të rrisë kuriozitetin e klientëve dhe në rast se jeni person krijues mund ti shtoni secilës picë detaje të ngjashme me personin në fjalë sipas karakteristikave të tij.

Vendi Ideal: Zona urbane, turistike, etj



45 POSTERAT NË KOMUNITET


Sektori: Shërbime, Art

Përshkrimi: Në rrugët e qyteteve tona shohim shumë hapësira boshe ose të vjetra të cilat na "vrasin" syrin me elementët e tyre të shëmtuar. Fatkeqësisht pronarët e ambienteve përkatëse ose institucionet e pushteti lokal e kanë të vështirë ti zëvendësojnë këto pamje me investime të reja e të bukura pasi kjo kërkon shumë fonde dhe kohë. Nga ana tjetër shumë biznese që mund të ndodhen ngjitur apo pranë këtyre ambienteve mund të preken negativisht nga këto pamje jo të këndëshme. Për këtë në sjellim një zgjidhje të thejshme, praktike dhe me kosto të ulët. Bëhet fjalë për idenë e posterave të varur në komunitet. Të gjithë ata që do të dëshirojnë të mbulojnë provizorisht ambjente që duken keq dhe që i pengojnë në aktivitetin e tyre mund të porosisin shërbimin tuaj për të printuar dhe mbuluar këto pamje me postera të mëdhenj sipas përmasave. Duke qenë se posterat printohen nga kompjuteri ato ofrojnë mundësi pa fund për të zëvendësuar pamjet e shëmtuara me pamje të bukura të të gjitha llojeve e të përshtura me ambientin përreth. Përmes kësaj teknike ju mund të bëni art e të ktheni ambjentet e qytetit në ambjente shlodhëse e tërheqëse me kosto të ulët e me përfitim për banorët përreth.

Kapitali i nevojshëm: 200,000 – 300,000 Lekë (materiale, banera, printime)

Vendi Ideal: Zona urbane, turistike, etj

Numri i personave: 1 – 3 persona



46 PARKING MAKINASH ME KATE

Sektori: Shërbime

Përshkrimi: Parkingu i makinave është sot një nga problematikat kryesore të qytetarëve dhe bizneseve në qytetet e mëdha. Hapësirat e këtyre qyteteve sa vijnë dhe zvogëlohen dhe mungesa e parkingjeve publike e bën më të vështirë situatën.

Për të plotësuar nevojat e vashdueshme për parkim janë gjeneruar shumë ide dhe mënyra përfitimi të drejta ose jo, që nga ofrimi i hapsirave të ndryshme private për parkim publik me pagesë sado të vogla qofshin ato e deri tek krijimi i zonave të influencës për grupe të ndryshme të rinjsh të papunë të cilët kanë "zaptuar" parkingjet publike dhe i zënë ato duke i ofruar gjithashtu me pagesë.

Ideja në fjalë vjen si zgjidhje shumë efikase nga qytete me problematikë të ngjashme dhe metropole të mëdha të cilat e kanë shumë të vështirë të ofrojnë zgjidhje të plotë për të gjitha kërkesat për parkim. Kjo ide ofron mundësinë e parkimit me kate përmes disa pajisjeve të thjeshta të cilat funksionojnë me sisteme hidraulike për ngritjen dhe uljen e automjeteve e ngjashme me ato që përdorin serviset dhe ofiçinat e makinave.

Kjo ide mund të përdoret nga persona të interesuar për ta kthyer këtë në biznes e duke ofruar këto pajisje për të gjithë ata që ofrojnë ambiente parkimi dhe që duan të rrisin të ardhurat e tyre pa pasur nevojë për të shtuar sipërfaqet e tyre. Përmes kësaj teknike sipërfaqja në dispozicion shfrytëzohet deri në tre ose katër herë më shumë dhe e njëjta gjë ndodh edhe me të ardhurat dhe fitimet.

Nga ana tjetër kjo ide do të zgjidhte në vetvete edhe një fenomen i cili mund të konsiderohet si një fenomen social në ditët e sotme për shkak të stresit dhe faktorëve të tjerë që sjell.

E njëjta pajisje mund të përdoret jo vetëm në qendër të qyteteve por edhe në vende të tjera të populluara si plazhe, ambiente fundjave, institucione ose edhe vila private në rast të ambienteve të kufizuara. Kjo pajisje vjen në forma dhe sisteme të ndryshme duke iu përshtatur hapësirave dhe nevojave.

Kapitali i nevojshëm: 400,000 – 500,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona urbane



47 BIÇIKLETA TAKSI

Sektori: Shërbime transporti

Përshkrimi: Një qytet si Tirana ofron mundësi të kufizuara të transportit dhe hapësirave. Nëse jeni në kërkim të një ideje të re dhe mundësie vetëpunësimi gjithshu, atëher kjo ide mund të jetë një mundësi për të filluar aktivitetin tuaj me kosto të ulët. Nëse jeni tip sportiv dhe ju pëlqen puna në terren atëher kjo mund të jetë akoma më shumë ideja që bën për ju. Në kushtet e një trafiku të rënduar dhe të pamundur në oraret e pikut ideja e biçikletës taksi mund të jetë një përvojë shumë e suksesshme për lëvizje të shpejta në rrugët e qyteteve të mëdha. Përveç udhëtarëve që duan të shfrytëzojnë lëvizjen me çmime të lira dhe që duan të shmangin trafikun e lëvizur shpejt, kjo mënyrë transporti mund të kthehet në atraksion edhe për turistët e ndryshëm të cilët duan të shijojnë një xhiro në zonat turistike të qyteteve.

Ky aktivitet konsiderohet si një aktivitet me kosto të ulët për shkak të investimit të ulët në financimin e mjetit, taksave të ulëta dhe kostove pothuaj inekzistente të lëvizjes. Mjeti lëvizet me tre rrota mund të përdoret njekohësisht edhe si mundësi promovimi dhe reklamimi për firma të ndryshme duke rritur kështu të ardhurat e të vetëpunësuarit. Për më shumë për dikë tjetër kjo ide mund të zgjerohet duke krijuar një skuadër dhe duke punësuar persona të tjerë për mbulim më të gjerë të zonave të qytetit.

Ideja e biçikletave taksi promovohet gjithashtu edhe për faktin se është një biznes i gjelbër, që ruan ambientin dhe ekologjinë.

Kapitali i nevojshëm: 250,000 – 300,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i personave: 1 – 2 person



48 PASTRIM XHAMASH ME UNIFORMA PERSONAZHESH

Sektori: Pastrim, Shërbime, Biznes Social

Përshkrimi: Kjo ide lidh ngushtë ofrimin e një shërbimi me argëtimin dhe idetë krijuese. Ka të bëjë me shërbimin e pastrimit të xhamave për biznese apo institucione të ndryshme por e veçanta në këtë rast është se punonjësit vishen me personazhe të famshëm filmash për fëmijë (spiderman) në vend të uniformave të zakonshme të punës. Kjo e bën shërbimin e tyre më tërheqës dhe të njohur në zonat ku ai ofrohet. Nje shërbim i tillë mund të reklamohet edhe në institucionet shtetërore apo bashkitë për të lidhur marrëveshje me to.

Kapitali i nevojshëm: 200,000 – 400,000 Lekë

Vendi Ideal: Zonat urbane, qytete të mëdha dhe bregdetare

Numri i personave: 4 – 5 person



49 ORGANIZIMI I SKUADRAVE SPORTIVE

Sektori: Sport, Trajnim

Përshkrimi: Në rast se keni aftësi ose eksperiencia sportive mund ti përdorni ato si një mundësi vetë-punësimi duke ofruar trajnim për të rinjtë në zonën tuaj. Kjo ide mund të zbatohet me ngritjen e skuadrave me grupmosha të ndryshme në sportet futboll, basketboll etj. Në këtë rast prindërit do të ishin të interesuar të paguanin një pagesë mujore dhe disa donatorë mund ta financojnë nismën tuaj për të përfshirë të rinjtë në aktivitete të dobishme. Ju nevojitet një ambient të cilin mund ta merrni me qera dhe mjete didaktike (uniforma, topa, rrjeta etj) në varësi të sportit.

Kapitali i nevojshëm: 150,000 – 200,000 Lekë

Vendi Ideal: : Zona ku nuk ofrohen shërbime të tilla, komunitete me numër të madh të rinjsh, zona pranë shkollave (fushat e të cilave mund të merren me qera për zbatimin e idesë).

Numri i personave: 1- 2 persona



50 RIPARUES KONDICIONERI PËR MAKINA

Sektori: Sport, Shërbime, Vetë-punësim

Përshkrimi: Ndonëse një zanat i pranishëm aktualisht në tregun e profesioneve nevoja për të riparuar kondicionerët e makinave mbetet një domosdoshmëri dhe kërkesë e lartë nga ana e përdoruesve të mjeteve numri i të cilëve sa vjen dhe rritet. E kemi vendosur në listën tonë për shkak të mundësisë së lartë të punësimit që ofron ky sektor dhe për arsye të mundësive konkrete dhe të arritshme për tu trajnuar dhe aftësuar në këtë fushë. Trajnimi për këtë profesion mund të merret në qendra formimi profesional ose përmes trajnimit në punë direkt në biznes. Nëse merrni këtë profesion dhe dispononi pajisjen përkatëse (të cilën mund të blini edhe të përdorur) mund ti ofroni serviseve të makinave që nuk e ofrojnë këtë shërbim të bashkëpunoni duke e shtuar atë në ambientet e tyre përkundrejt një marrëveshje ekonomike.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 – 150,000 Lekë

Vendi Ideal: Më së shumti në qytete por edhe zona rurale, kudo ku përdoren mjete.



51 DEZINFEKTIMI


Sektori: Shërbime, Higjena

Përshkrimi: Nevoja për të dizinfektuar ambientet në ditët e sotme është e madhe. Kjo ide mund të realizohet nga një grup personash të cilët mund ta ofrojnë këtë shërbim në biznese të zonës, në fabrika, dyqane apo edhe ambiente familjare sipas nevojave. Nevojitet të keni njohuri për substancat e përdorura dhe mënyrat e përdorimit të cilat mund të fitohen përmes një trajnimit në punë apo stazhi afatgjatë në kompani të ngjashme. Më pas personi i trajnuar krijon një grup pune të cilët drejtohen nga ai.

Kapitali i nevojshëm: 200,000 – 300,000 Lekë

Vendi Ideal: Qytete të mëdha, Zona Industriale

Numri i Personave: 3 – 4 persona



52 PASTRUES PISHINASH

Sektori: Shërbime Pastrimi

Përshkrimi: Numri i subjekteve të biznesit apo familjarë që ndërtojnë pishina në ditët e sotme sa vjen dhe rritet. Ndërtimi i tyre sjell mundësi përfitimi për pronarët e tyre pasi është një shërbim shtesë por edhe i pëlqyeshëm nga shumë grupmosha. Por paralelisht me përdorimin e tyre pishinat kanë nevojë edhe për pastrime të vazhdueshme të cilat mund të ofrohen nga individë të trajnuar në këtë fushë. Në rast se dëshironi të fokusoheni në këtë fushë mund të krijoni lidhje me disa biznese dhe në fund do të keni një pagesë mujore të kënaqëshme.

Kapitali i nevojshëm: 50,000 – 100,000 Lekë

Vendi Ideal: Qytete, zona bregdetare, hotele, restorante me pishina, vila me pishina

Numri i Personave: 1 persona



53 TRANSPORTUES I PAVARUR

Sektori: Shërbime, Transport

Përshkrimi: Ideja për të ofruar shërbime transporti me mjetin personal ka funksionuar në shumë shtete të ndryshme por edhe zona të vendit tonë. Në rast se jeni person i shkathët dhe me aftësi të mira në drejtimin e mjetit mund ta konsideroni këtë si një mënyrë punësimi. Pajisja me nje leje drejtimi dhe më pas me një mjet transporti të vogël tre apo katër rrotësh mund të shërbejë për shumë persona apo biznese të zonës si një mënyrë për të transportuar mallra industrial apo bujqësor në zona të ndryshme. Pasja e një mjeti të tillë ju vë gjithmon në lëvizje.

Kapitali i nevojshëm: 250,000 – 400,000 Lekë

Vendi Ideal: Kudo në qytete apo zona rurale

Numri i Personave: 1 – 2 persona



54 FOTOGRAF / E

Sektori: Shërbime, Argëtim, Art

Përshkrimi: Idenë për të ofruar shërbime fotografie e kemi sjellë pasi lidhet me nevojën aktuale të shumë njerëzve për të pasur kujtime nga momentet e tyre të gëzuara. Tradita jonë përmban shumë rite dhe zakone të cilat vazhdojnë të festohen dhe roli i fotografit mbetet akoma shumë i rëndësishëm. Pa dyshim që numri i madh i fotografëve sot do të thotë konkurrencë dhe më të kërkuarit janë ata të cilët ofrojnë diçka ndryshe. Për shembull nëse një femër do të bëhej fotografe në një qytet të vogël kjo do të bënte përshtypje por do ta bënte atë edhe të veçantë nga e zakonshmja dhe të kërkuar më shumë se burrat. Është një ide që kërkon investim të ulët në trajnim dhe pajisje, dhe që mund të merret nga kushdo që e pëlqen artin.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 – 150,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona Urbane (qytete)

Numri i Personave: 1 person



55 DREJTUES MJETESH TË RËNDA

Sektori: Transport, ndërtim

Përshkrimi: Marrja e një zanati të mirë është diçka e rëndësishme në ditët e sotme. Në kohën kur tregu i profesioneve po drejtohet gjithmonë e me shumë drejt zanateve fikse ka disa të tjera të cilat po neglizhohen por nevoja për to akoma ekziston. Kështu është edhe rasti i drejtimit të mjeteve të rënda. Ky profesion mund të jetë një siguri e mirë për jetën pasi firma të ndryshme vendase apo të huaja kërkojnë punonjës të tillë për punë në fushat e ndërtimit të rrugëve, naftës, gazit, hidrocentraleve etj.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona Industriale

Numri i Personave: 1 person



56 SHITËS AMBULANT


Sektori: Ambulant, Shërbime, Vetë-punësim

Përshkrimi: Kjo është ideja e vetë-punësimit përmes shërbimeve lëvizëse. Në këtë rast mund të ofrohet akullorja si produkt në sezonin veror por ky shërbim mund të funksionojë edhe në stinë të tjera me produkte të ndryshme. Ideja e lëvizshmërisë ju ofron mundësi të arrini klientët direct në plazhe, rrugë, shëtitore, shkolla, lagje apo institucione. Për ta bërë më tërheqës shërbimin dhe më argëtues për fëmijët mund të vendosni në mjetin tuaj lëvizës një muzikë e cila të identifikohet me akulloren. Në këtë rast fëmijët do të vrapojnë tek ju sapo të dëgjojnë muzikën tua.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 – 150,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona Urbane (qytete), zona bregdetare

Numri i Personave: 1 person



57 KËND LOJRASH PRIVAT

Sektori: Argëtim, Shërbime

Përshkrimi: Në rast se doni të angazhoheni në një aktivitet të veçantë në zonën ku jetoni mund të provoni idenë e ofrimit të një këndi lojrash për fëmijë kundrejt një pagese të përbalueshme nga prindërit. Nevoja për ambiente publike dhe sidomos për hapësira ku fëmijët mund të luajnë është shumë e madhe. Në rast se keni një terren tuajin apo mund ta gjeni me qera mund të konsideroni idenë të merrni disa lodra për fëmijë me kosto jo shumë të lartë dhe ti vendosni aty. Krahas lodrave në ambientet e ketij këndi mund të ofroni edhe disa shërbime të tjera si një minibar, tualet etj për të plotësuar nevojat e vizitorëve.

Kapitali i nevojshëm: 300,000 – 500,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona Urbane (qytete)

Numri i Personave: 1 – 2 persona



58 LAVAZH MAKINASH

Sektori: Shërbime, Automjete

Përshkrimi: Të ndërtosh një lavazh makinash nuk është diçka e re por ta ndërtosh atë në një zonë kyçe ku ka shumë makina por jo lavazhe të tjera është diçka fitimprurëse. Organizimi i një aktiviteti të tillë nuk kërkon shumë investim dhe mund të punësojë deri në 4 persona duke u kthyer në një mundësi të mirë për një grup shokësh apo familjarësh. Pa dyshim që suksesi i kësaj ideje është cilësia dhe korrektesa në shërbimin e ofruar. Solucionet me të cilat lahen mjetet dhe detaje të tjera do tju rrisnin numrin e klientëve

Kapitali i nevojshëm: 200,000 – 300,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona Urbane (qytete)

Numri i Personave: 2 – 5 persona



59 TEKNIK ASHENSORESH

Sektori: Shërbime, Siguri

Përshkrimi: Pasja e një profesioni të mirë është një siguri ekonomike për secilin nga ne. Të marrësh zanatin e teknikut për ashensorë mund të jetë një mënyrë e mirë punësimi. Duke qenë se teknik i mirfilltë bëhesh përmes arsimit të zakonshëm dhe të gjatë profesional një mundësi e mirë do të ishte edhe marrja e zanatit direkt nga biznesi në formën e stazheve afatgjata ose trajnimit në punë. Numri i madh i ndërtimeve të larta së fundmi ka rritur nevojën për shërbime mirëmbajtje të këtyre godinave dhe specifikisht të ashensorëve. Ju mund të filloni si ndihmës e me kalimin e kohës duke fituar eksperiencë mund të ngjisni shkallët e profesionit.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 Lekë (trajnim, stazh dhe vegla)

Vendi Ideal: Zona Urbane (qytete)

Numri i Personave: 1 person



60 CICERON

Sektori: Kulturë, Histori, Argëtim

Përshkrimi: Nëse jeni një person i komunikueshëm dhe njihni një gjuhë të huaj mund ta përdorni këtë aftësi për të ofruar shërbimin tuaj për agjensi turistike por edhe direkt për individë që vizitojnë qytetin tuaj. Në shumë zona historike apo arkeologjike mungon shërbimi i informacionit për të huajt dhe kështu ju mund të ofroni të tregoni historitë dhe legjendat që lidhen me atë vend përkundrejt një pagese modeste. Vizitorët do të jenë të kënaqur të mësojnë rreth vendeve të ndryshme dhe të argëtohen me mënyrën tuaj të treguarit.

Kapitali i nevojshëm: 50,000 - 100,000 Lekë (kurs për gjuhën dhe mjete promovimi)

Vendi Ideal: Zona Urbane (qytete), zona historike, arkeologjike

Numri i Personave: 1 person



61 SERË ME PRODHIME TË NDRYSHME


Sektori: Agrikulturë, Vetë-punësim

Përshkrimi: Kjo ide ka të bëjë me ndërtimin e një sere bujqësore në zona rurale ose pranë qyteteve për të kultivuar produkte të cilat janë të kërkuara në treg. Zakonisht kjo ide funksionon me ato produkte të cilat dalin në treg për një periudhë kohe të shkurtër ndërkohë që nevoja nga klientët është e shtrirë në një periudhë më të gjatë. Duke qenë se në sera bimët rriten në kushtë të tjera klimaterike ju do të mundeni ti ofroni tregut produkte të cilat nuk gjenden normalisht në atë sezon. Origjinaliteti është një tjetër element i cili mund ta bëjë prodhimin tuaj të kërkuar nga tregtarët e shumicës pasi klientët paguajnë më shumë për produktet BIO pa pesticide apo element të tjerë të dëmshëm. Sera juaj mund të kompozohet edhe për prodhimin e bimëve dekorative fushë e cila gjithashtu është me interes për tregun. Për këtë ju nevojiten aftësi në agrikulturë dhe një terren i përshtatshëm.

Kapitali i nevojshëm: 200,000 – 250,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona Rurale

Numri i Personave: 1 - 2 persona



62 MBARËSHTIM KAFSHËSH


Sektori: Blegtori

Përshkrimi: Shumë të rinj sot po largohen nga fshati pasi e konsiderojnë atë si jo fitimprurës për të ardhmen e tyre. Por të mendosh për të filluar një aktivitet me kafshë të ndryshme nuk është një ide e keqe. Në çdo situatë aftësia riprodhuese e kafshëve të fermës do t'ju kthejë pas investimit që do të kryeni në fillim. Nëse keni një ambient ose terren në një zonë të përshtatshme rurale mund ta organizoni atë për të mbajtur lloje të ndryshme kafshësh përmes të cilave do të keni përfitime të ndryshme afatshkurtra dhe afatgjata. Pa dyshim që edhe kjo mënyrë punësimi ka mund dhe kërkon aftësi profesionale, ndoshta edhe ndihmën e një specialist për ndërtimin e amjentit dhe përkujdesin e vazhdueshëm. Disa prej këtyre llojeve kanë pjellori të lartë dhe janë me interes: derri, dhia, etj.

Kapitali i nevojshëm: 150,000 – 250,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona Rurale (qytete)

Numri i Personave: 1 - 2 persona



63 NDËRTIMI I NJË DEPOZITE PËR MBETJET E KAFSHËVE

Sektori: Blegtori, Bujqësi, Shërbime

Përshkrimi: Në momentet kur plehrat që tregëtohen për bujqësinë shiten me çmime të larta dhe tregu kërkon gjithmmon e më shumë prodhime BIO ideja për të hapur një depozitë për mbetjet e kafshëve mund të funksionojë. Sot pjesa më e madhe e mbetjeve nuk përdoren dhe një mënyre e organizuar grumbullimi do tju jeptë një shans të mirë për lëndë të parë e cila të shitej tek fermerët lokalë pas përpunimit të saj. Për realizimin e kësaj ideje ju duhet një terren, struktura për grumbullimin dhe përpunimin, një mjet shpërndarës dhe reklamim për shërbimin.

Kapitali i nevojshëm: 300,000 – 350,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona rurale (fshatra)

Numri i Personave: 1 – 3 persona



64 KABINAT

Sektori: Argëtim, Turizëm

Përshkrimi: Keni menduar ndonjëherë se sa pak nevojitet për të kaluar moment relaksi dhe argëtimi me miqtë apo familjarët. Ju mund ta ofroni këtë shërbim në mënyrë shumë të thjeshtë për grupmosha të ndryshme. Kjo është ideja e ndërtimit të disa kabinave të vogla prej druri në zona të qeta jo shumë larg qytetit ku njerëz të ndryshëm të kenë mundësinë të kalojnë një natë relaksi nën shoqërinë e natyrës dhe ushqimit të zgarës. Këto kabina mund të kenë një mobilim simbolik të përshtatur me natyrën dhe krahas akomodimit mund të ofrohet edhe ndonjë shërbim si pije, ushqim i shpejtë etj. Gjithashtu mund të ofrohen aktivitete dhe muzikë nga kultura e komuniteteve të ndryshme për ta bërë atmosferën më festive. Kjo ide mund të fillojë me tre ose katër kabina dhe të zgjerohet në një moment më të vonë.

Kapitali i nevojshëm: 600,000 – 800,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona periferike, zona me bimësi, pranë lumenjve ose liqeneve, terrene me qera ose në pronësi.

Numri i Personave: 2- 4 persona



65 VESHJE ME PERSONAZHE FËMIJËSH TË PUNUARA ME DORË


Sektori: Punime dore, vetë-punësim, veshje, artizanat

Përshkrimi: Nëse keni aftësi në punimet e dorës dhe të artizanatit kjo është një ide shumë e mirë që ndërthur aftësinë tuaj me idetë krijuese, e cila do tju ndihmonte të përshtateshit më mirë me nevojat e tregut dhe të shisnit më shumë. Kjo ide lidhet me prodhimin përmes artizanatit dhe dorës të veshjeve me personazhe për fëmijë. Fëmijët i pëlqejnë shumë këto veshje të cilat i veshin për festa ose dhe gjatë ditës dhe prindërit nuk hezitojnë shumë për të shpenzuar për këto artikuj. Shumica e këtyre veshjeve aktualisht në treg janë të eksportuara nga jashtë dhe në rast se ju do të prodhoni diçka origjinale me dorë dhe me cilësi të lartë kjo do ta rriste shumë vlerën e punës tuaj. Shitja e këtyre artikujve mund të bëhet përmes rrjetit të dyqaneve ekzistues ose internetit, facebookut etj. Ideja mund të funksionojë si individ por edhe në grup të organizuar.

Kapitali i nevojshëm: 50,000 – 100,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona Urbane (qytete)

Numri i Personave: 1 – 5 - ... persona



66 PASTRIMI I QEPENËVE


Sektori: Shërbim pastrimi

Përshkrimi: Një ide gjeniale vjen së fundmi si një mundësi vetë-punësimi. Kjo ide ka të bëjë me pastrimin e qepenëve të dyqaneve të ndryshme në qytetet tona. Askush deri më sot nuk ka ofruar një shërbim të tillë por të nevojshëm. Qepenat e dyqaneve ndoten gjatë gjithë kohës nga pluhuri dhe papastërtitë e tjera të ambientit ku ndodhen. Shpesh ato edhe ngecin për shkak të mospastrimit të tyre dhe grasatimit të vazhdueshëm. Për këtë arsye shërbimi i pastrimit dhe grasatimit të tyre kundrejt një pagese minimale mund të jetë me përfitim për biznesin por edhe për vetë personin që do ta ofrojë këtë shërbim. Në rastet kur bizneset shfaqin interes mund tu kërkoni atyre që të riktheheni përsëri pas një afati të caktuar për të ofruar shërbimin, duke krijuar kështu rrjetin tuaj të klientëve.

Kapitali i nevojshëm: 30,000 – 50,000 Lekë (mjete pastrimi, graso, etj)

Vendi Ideal: Zona Urbane

Numri i Personave: 1 - 2 persona



67 SHËTITJE ME KARROCË

Sektori: Argëtim, Shërbim

Përshkrimi: Argëtimi mund të jetë një burim fitimi për shumë persona që pëlqejnë idenë e ofrimit të transportit tradicional dhe kulturor. Ideja e lëvizjes me karrocë të stilit të vjetër në rrugët e qytetit si një mënyrë argëtimi dhe turistike është e preferuar në shumë qytete në mbarë botën. Ajo ofron një formë të ndryshme lëvizjeje por shumë më tërheqëse për vizitorët të cilët duan të shijojnë bukuritë e vendit tonë sipas mënyrës së vjetër. Ndërthurja e këtij shërbimi me elemente karakteristike të komuniteteve të caktuara mund ti shtojë bukurinë mjetit dhe shërbimit në tërësi. Ky lloj mjeti mund të përdoret në rrugë të veçanta mundësisht pedonale dhe historike kundrejt një pagese sipas distancës.

Kapitali i nevojshëm: 150,000 – 200,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona Urbane (qytete), zona bregdetare

Numri i Personave: 1 - 2 persona



68 FAQE INTERNETI PËR PUNIMET E DORËS

Sektori: Internet, Tregëti, Artizanat, Kulturë

Përshkrimi: Promovimi i produkteve artizanale dhe të dorës mbetet një sfidë e vështirë në tregun Shqiptar. Më së shumti njerëzit përpiqen ti shesin ato individualisht sipas mënyrave të ndryshme. Ideja në fjalë sjell një mënyrë të organizuar të grumbullimit të këtyre produkteve dhe shitjes së tyre edhe përmes internetit. Një faqe e organizuar mirë me kategori produktesh, detaje mbi cilësinë, çmime dhe elementë të tjerë do të shtonin mundësitë që këto prodhime të punuara nga kategori të ndryshme të bëheshin më vizibël për blerësit. Shitja përmes internetit kërkon aftësi të mira kompjuterike por edhe marketing. Në këto faqe mund të promovohet edhe origjinaliteti, historiku dhe informacione të tjera mbi produktet dhe prodhuesit e këtyre artikujve. Për të qenë sa më konkurren në tregun e stërmadh të internetit produktet mund edhe të adoptohen sipas stileve, modës dhe krijimeve të kohëve të fundit.

Kapitali i nevojshëm: 50,000 – 100,000 Lekë (ndërtimi i faqes dhe materiale promovuese)

Vendi Ideal: E përgjithshme

Numri i Personave: 1 – 3 persona



69 RIKIKLIMI I ORGANIZUAR I PLASTIKËS

Sektori: Ambjent, Shërbime, Vetë-punësim

Përshkrimi: Ky aktivitet zhvillohet aktualisht në forma të ndryshme por më së shumti në mënyrë të paorganizuar dhe individuale. Ideja jonë promovon ndërtimin e një plani konkret pune për ofrimin e këtij shërbimi në mënyrë të organizuar duke përfshirë edhe pajisje për paketimin e plastikës së mbledhur. Duke qenë se ky aktivitet është një proces i gjatë ju mund të përfshiheni duke ofruar një pjesë të zinxhirit të aktivitetit në zonën tuaj. Mund të angazhoni njerëz për ti mbledhur ato nga familje ose biznese, ti grumbulloni dhe më pas ti shisni ato të papërpunuara ose gjysëm të përpunuara përmes një pajisjeje të posaçme. Ky aktivitet ka një impakt të madh mbi mjedisin por edhe siguron të ardhura për ata që merren me këtë. Për ta bërë sa më të organizuar grumbullimin, sugjerohet një plan i mirë sensibilizimi dhe lidhjesh me bizneset e zonës.

Kapitali i nevojshëm: 500,000 – 700,000 Lekë (përfshin pajisjen e përpunimit të plastikës)

Vendi Ideal: Zona urbane dhe rurale. Nevojitet truall për grumbullimin e materialve.

Numri i Personave: 4 - 10 persona



70 TË BËHESH DJ

Sektori: Art, Muzikë

Përshkrimi: Të bëhesh DJ i mirë është sa e bukur por edhe e vështirë. Shumë të rinj sot e pëlqejnë muzikën dhe dëshirojnë ta lidhin profesionin e tyre me të. Nëse keni dhunti dhe aftësi muzikore mund të investoni për tu specializuar më shumë në këtë drejtim dhe përmes aparaturave dhe teknologjisë ta ofroni këtë shërbim për festa, ditëlindje, dasma etj në zonën ku jetoni apo edhe më tej.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona urbane (qytete), zona bregdetare

Numri i Personave: 1 person



71 ORGANIZATOR FESTASH

Sektori: Art, Muzikë

Përshkrimi: Nëse mendoni se keni aftësi organizuese, komunikuese dhe dini lojra të ndryshme atëherë ideja për të ndërtuar një aktivitet si planifikues festash mund të jetë për ju. Sot njerëzit organizojnë festa me qëllime të ndryshme por ajo që në të vertet u mungon është koha në dispozicion dhe informacioni për materialet e ndryshme që kërkohen për një festë ideale. Ju mund të ofroni shërbimet tuaja për këtë nevojë duke siguruar që personat të cilët festojnë të marrin çdo gjë në kohën e duhur dhe në mënyrë cilësore pa u lodhur por duke paguar një pagesë të caktuar. Për të qenë më konkures se konkurentët e tjerë që ofrojnë shërbime të ngjashme sugjerohet të ofrohen çmime më të ulëta, produkte cilësore dhe aktivitete shtesë të kombinuara si për shembull, pajisja me veshje dhe mjete për festa fëmijësh, shërbim DJ, valltarë, fotograf etj.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 – 150,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona Urbane (qytete)

Numri i Personave: 1 – 3 persona



72 KAFENEJA E LOJRAVE

Sektori: Argëtim

Përshkrimi: Një nga mënyrat e reja për të pasur klientë të sigurtë në lokale apo ambiente biznesi është edhe ofrimi i lojrave të ndryshme të tavolinës si shah, tavëll, letra, domino, etj, për klientët. Kjo formë e re argëtimi për të rinj dhe grupmosha të ndryshme është tërheqëse dhe garanton klientelë të vazhdueshme në ambientet tuaja. Në rast se ju pëlqen kjo ide mund të mendoni të hapni një ambient modest të ngjashëm ku të kombinoni shërbimet e barit, argëtimit dhe internetit.

Kapitali i nevojshëm: 200,000 – 300,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona Urbane (qytete), zona studentore

Numri i Personave: 1 – 3 persona



73 MBARËSHTIMI I STRUCIT

Përshkrimi: Struci është një nga shpendët më interesantë për mbarështim. Ai ka një pjellori të lartë dhe mishi i tij preferohet shumë në vendet perëndimore për shkak të kolesterolit të ulët. Për këtë arsye ai shitet për një çmim të lartë dhe është fitimprurës. Jo pa qëllim e sollëm si ide në listën tonë pasi mund të jetë një mundësi e mirë biznesi për ata që pëlqejnë të merrën me shpendët. Një fermë strucash kërkon disa element infrastrukturorë por mund të realizohet pa shumë vështirësi. Për realizimin e idesë ju nevojitet një truall ku do të ndërtoni infrastrukturën për këtë aktivitet. Shitja e prodhimit nuk është e vështirë pasi shumë kompani më së shumti nga Franca interesohen për këtë produkt. Kushtet klimaterike të vendit tonë janë gjithashtu të favorshme për këtë specie.

Kapitali i nevojshëm: 200,000 – 300,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona rurale

Info: <http://en.wikipedia.org/wiki/Ostrich>
<https://www.facebook.com/DrizaCompany>



74 DYQAN GRUMBULLIMI RRQBASH DHE MOBILJESH TË PËRDORURA

Sektori: Veshje, Mobilim, Tregëti

Përshkrimi: Në kohët e konsumit ditor ku po kalon shoqëria jonë shumë njerëz ndërrojnë shpesh mobilje, pajisje dhe veshje të ndryshme. Shpesh ato falen, hidhen ose shiten për pak para. Këtë fenomen mund ta përdorni për të ndërtuar një rrjet furnizimi, magazinimi dhe shitje të objekteve të përdorura. Këto materiale ju mund t'i merrni falas përmes një promovioni apo kundrejt një pagese simbolike dhe t'i rishisni po me çmime të ulta për kategoritë në nevojë. Kjo mund të jetë një ide e mirë edhe për organizimin e një biznesi social me disa antarë të komunitetit. Qëllimi i aktivitetit mund të jetë ndërgjegjësimi i popullatës për të dhuruar pajisje dhe materiale të përdorura nga shtëpitë e tyre, të cilat shiten me çmime të lira dhe përfitimet përdoren për nevojat e komunitetit në nevojë.

Kapitali i nevojshëm: 300,000 – 400,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona urbane të populluara, nevojitet një hapësirë e madhe, magazinë etj për mbajtjen e materialeve.

Numri i Personave: 2 – 4 persona

Info: Shtëpia e Ofertave, Tiranë



75 ÇADRA KASHTE FAMILJARE DHE ME NGJYRA


Sektori: Artizanat

Përshkrimi: Ndërtimi i çadrave me material kashte është diçka masive në ditët e sotme. Ky lloj produkti është në modë në të gjithë plazhet e vendit dhe bizneset përkatëse porosisin sasi të mjaftueshme për të plotësuar plazhet private. Ideja që ne sjellim është prodhimi i çadrave prej kashte për përdorim familjar të cilat palosen dhe janë me ngjyra. Megjithëse kashta në vetvete jep një pamje të këndshme dhe ka ngjyrë të bukur lyerja e saj me ngjyra të tjera do të ofronte më shumë larmi, veçanti dhe do ti përshtatet stinës së verës. Ndërkohë që prodhimi i çadrave të palosëshme për familje mund të jetë një tjetër formë tërheqëse. Të dyja këto sugjerime mund të krijojnë një modë të re dhe krijuese për këdo që dëshiron të merret me këtë aktivitet. Si fillim nevojitet një ambient për ndërtimin e produkteve. Reklamimi është një tjetër aspekt i cili mund të arrihet përmes një fletëpalsoje modeste me ngjyra.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 – 150,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona bregdetare, zona pushimi.

Numri i Personave: 2 – 3 persona



76 PRODHIMI I SITAVE

Sektori: Artizanat

Përshkrimi: Sitat artizanale për pastrimin dhe hollimin e miellit janë prodhuar prej vitesh në mënyrë tradicionale nga artizanatët Shqiptarë. Ky zanat sa vjen e po zhduket pasi brezat e rinj nuk janë shumë të interesuar dhe në treg kanë hyrë produkte të fabrikuara të gatshme. Por në rast se dikush vendos të mbajë gjallë këtë trashëgimni kjo mund të kthehet në ide shumë të mirë punësimi pasi nevoja për produkte cilësore të prodhuara me dorë është e madhe, sidomos në zona rurale ku këto sita përdoren akoma. Gjithashtu me interes është edhe procesi i prodhimit të këtyre sitave i cili mund të jetë atraktiv edhe për vizitorët e huaj.

Kapitali i nevojshëm: 50,000 – 100,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona bregdetare, zona pushimi.

Numri i Personave: 1 person

Info: Një mjeshtër në Tiranë ofron akoma mundësinë për të mësuar prodhimin tradicional të sitave të madhësive të ndryshme.



77 KORNIZA ME MOTIVE ORIGINALE

Sektori: Artizanat, art

Përshkrimi: Ndërthurja e materialeve artistike si kornizat me traditën dhe kulturën e një komuniteti të caktuar është një risi e cila po përhapet në disa vende të botës. Prodhimi i kornizave dhe lyerja e tyre totalisht me dorë rrit vlerën artistike të këtyre produkteve. Kjo lloj ndërmarrje do të promovojë gjithashtu kulturën dhe simbolet e komunitetit që i prodhon duke i bërë ato të njohura. Këto produkte mund të shiten në përshtatje me vendin dhe zonën, në hyrje të objekteve që vizitohen nga turistë apo dyqane suvenirësh.

Kapitali i nevojshëm: 70,000 – 120,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona turistike, qendrat e qyteteve

Numri i Personave: 2 – 3 persona



78 PANAIRI LËVIZËS

Sektori: Tregëti

Përshkrimi: Kjo ide nënkupton shitjen e produkteve në vende të ndryshme në mënyrë të organizuar. Në rast se jeni një grup tregtarësh që shisni mallra të ndryshme mund të organizoheni që të krijoni minitregje në zona të ndryshme (qytete, fshatra) sipas një kalendari të caktuar. Gjatë këtyre ditëve për klientët mund të ofrohet edhe argëtim në mënyrë që panairi të kthehet në një lloj feste dhe mundësi për të kaluar një ditë ndryshe. Mallrat që mund të shisni janë nga më të ndryshmet por që varen edhe nga vendi dhe lloji i klientëve. Prodhimet e artizanantit mund të jenë një vend të rëndësishëm në këtë panair dhe gjithashtu në qytet mund të shiten prodhime fshati kurse në fshat mallra industrial. Kurse në zona turistësh mund të tregëtohen prodhime që kanë lidhje me turizmin dhe promovimin vendit. Pajisje të motorizuara dhe stenda do të nevojiten për transportin e mallrave. Gjithashtu disa banera të ndryshëm do të shërbejnë si reklam për aktivitetin.

Kapitali i nevojshëm: 600,000 – 800,000 Lekë (mjete motorike, stenda, material, banera)

Vendi Ideal: Sheshe qytetesh, sheshe fshatrash, zona bregdetare, zona pushimi.

Numri i Personave: 4 – 10 persona

Info: Model i panairit të Tushemishtit, Pogradec



79 ÇIZMET ME MOTIVE

Sektori: Artizanat, Art, Tregëti


Përshkrimi: Në tregjet e veshjeve të përdorura gjen edhe shumë çizme të modeleve të ndryshme. Kjo ide ju sugjeron mundësinë për ti transformuar këto çizme në një artikull shumë interesant i cili mund të kthehet në modë për shumë njerëz që pëlqejnë ngjyrat. Nëse mund të siguron një burim të vazhdueshëm furnizimi me produkte të kësaj natyre mund të zhvilloni një aktivitet të qëndrueshëm. Produktet e riformuara me pamjen e re mund të tregëtohen duke u shpërndarë nëpër dyqane të tjera ose pika shitje të lëvizshme. Motivet dhe zbukurimet mund të lidhen me kulturën dhe traditën e komuniteteve të caktuara duke promovuar këtë tek grupet e tjera.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 – 150,000 Lekë (blerje materiali, boje, mjetesh, etj..)

Vendi Ideal: Zona tregëtare, qendra qyteti, bregdetare, zona pushimi.

Numri i Personave: 2 – 5 persona

Info: <http://tryhandmade.com/arts-on-n-festival-arts-market/>



80 MOBILJE ME PALETA

Sektori: Mobileri, Prodhim, Punime dore, Krijimtari

Përshkrimi: Mobilje me paleta është një ide krijuese me kosto të ulët e cila mundëson prodhimin e mobiljeve të ndryshme për ambiente familjare ose biznesi. Kjo ide përdor paletat industriale të mallrave të cilat mund të gjenden me kosto shumë të ulët. Përmes një procesi adoptimi, përshtatje dhe lyerje paletat kthehen në tavolina, krevatë, kolltukë, shkallë, dollapë për ambiente të brëndëshme apo të jashtme të cilat mund të ofrohen për shitje. Kosto e tyre e lirë dhe stili modern që krijojnë mundëson shitjen e tyre. Në rast se kjo ide ju pëlqen mund të organizoni një grup të vogël personash për proceset e ndryshme dhe gjithashtu një strategjie marketingu e cila do tju mundësojë suksesin.

Kapitali i nevojshëm: 150,000 – 250,000 Lekë (blerje materiali, boje, mjete, etj.)

Vendi Ideal: Zona tregëtare, qendra qyteti, bregdetare, zona pushimi.

Numri i Personave: 2 – 5 persona

Info: <http://palletfurnitureplans.com/category/pallet-furniture/>



81 LAVAMANËT FUÇI

Sektori: Mobileri, Prodhim, Artizanat

Përshkrimi: Kjo është ideja e transformimit të fuçive prej druri të verës në lavamanë simpatik për ambiente lokale por edhe për shtëpi moderne. Nëse jeni i dhënë pas punimit të drurit kjo është me të vertetë një ide që ju sjell kënaqësi dhe përfitim. Lavamanët e prodhuar me këto material të ricikluara ofrojnë një pamje tradicionale të veçantë të cilën shumë klientë mund ta pëlqejnë. Për këtë ide do tju duhet një minipunishte për përpunimin e fuçive dhe një plan marketingu për promovimin.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 – 150,000 Lekë (blerje materiali,

Vendi Ideal: Zona tregëtare, qendra qyteti, bregdetare, zona pushimi.

Numri i Personave: 1 – 3 persona



82 LLAMPAT ME NGJYRA

Sektori: Artizanat, Krijimtari, Vetë-punësim


Përshkrimi: Një ide ndryshe vjen nga fusha e ndriçimit. Një mënyrë artistike vetë-punësimi janë llampat e lyera me ngjyra. Nëse mendoni se keni aftësi për ta zhvilluar këtë aktivitet mund të ofroni shërbimin tuaj tek shitësit dhe shpërndarësit ekskluziv të këtyre produkteve. Këto janë llampa normale të cilat lyhen me bojra / ngjyra të ndryshme dhe ofrojnë një ndriçim modern kur vendosen në punë. Përmes kësaj teknike mund të krijohen produkte të ndryshme me shumë artikuj të fushës elektrike sipas periudhave të vitit dhe festave. Kjo ide nuk ka nevojë për ndonjë trajnim specifik apo për materiale të shtrenjta.

Kapitali i nevojshëm: 50,000 – 70,000 Lekë (blerje materiali, boje, mjete)

Vendi Ideal: Zona urbane

Numri i Personave: 1 – 2 persona

Info: <http://www.wikihow.com/Paint-a-Light-Bulb>



83 PIKTURA ME RUL

Sektori: Art

Përshkrimi: Një tjetër ide interesante vjen nga fusha e artit. Nëse keni passion dhe talent për pikturën dhe ngjyrat atëherë mund të krijoni një koleksion tuajin duke ushtruar zanatin e piktorit. Por ideja në fjalë është me e veçantë. Nuk kërkon edukim special në vizatim apo eksperiencë të gjatë. Majfton një telajo, një rul dhe disa bojra prej të cilave mund të prodhohen forma e kombinime të ndryshme. Si rezultat do të kemi piktura origjinale abstrakte dhe modern shumë të kërkuara nga subjekte të ndryshme apo individë. Kosto e lirë e tyre ju jep mundësinë të nxirrni në treg me një çmim të ulët. Gjithashtu për shitjen mund të përdorni internetin ose të reklamoni në një vend të dukshëm në qytet. Nëse afatësitë tuaja në pikturë janë më të mira ju mund të praktikoni edhe vizatimin e portreteve në moment në ambiente të hapura ose turistike.

Kapitali i nevojshëm: 30,000 – 50,000 Lekë (blerje materiali, boje, mjete)

Vendi Ideal: Në qendrat e qyteteve pranë zonave të populluara. Mund të ekspozohen edhe në ambiente të jashtme.

Numri i Personave: 1 person

Info: <http://www.wikihow.com/Create-an-Abstract-Painting>



84 MINI GRILL

Sektori: Gatim

Përshkrimi: Kjo është një ide inovative dhe krijuese për ata që duan të jenë të veçantë dhe konkurues njëkohësisht. Ka të bëjë me "riciklimin" dhe shndërrimin në objekte të tjera të mjeteve të cilat nuk i përdorim më. Në këtë rast ne ju paraqesim transformimin e një kutie metalike të një zgarë shumë efektive dhe të thjeshtë. Por qëllimi i kësaj ideje nuk është vetëm ky shembull por nxitja e fantazisë tek të rinjtë që kanë aftësi për punime të tilla që të përdorin mjete të ashtuquajtura pa vlerë dhe ti kthejnë ato në artikuj të nevojshëm për klientët duke krijuar kështu një aktivitet vetë përcaktues të ndryshëm nga ajo që jemi mësuar tradicionalisht. Për përgatitjen e kësaj zgarë nevojitet disa mjete bazike dhe sende rrethore dhe i gjithë suksesi qëndron tek aftësia krijuese. Kjo zgarë mund të përdoret nga shumë individë që pëlqejnë aktivitetet në ambiente të jashtme dhe kosto e ofruar mund të ofrojë shanse të larta për shitjen e tyre. Mjafton të prisni në formë të rregullt anët e kutisë dhe ti përthyeri sipas fotos, vendosni një lëtar alumini që gjendet kudo, gurë zalli, një rrjetë metalike sipër dhe ju do të keni zgarën tuaj që funksionon për mrekulli.

Kapitali i nevojshëm: 30,000 – 50,000 Lekë (blerje materiali, boje, mjete)

Vendi Ideal: Artikuj të ngjashëm mund të punohen në ambiente shtëpie dhe të ofrohen për shitje në vende të populluara, pazare, vende pikniku, plazhe etj.

Numri i Personave: 1 – 2 persona



85 PAJISJA SHTËPIAKE E BIRRËS

Sektori: Pije, Tregëti, Vetë-punësim

Përshkrimi: Nëse jeni i apasionuar pas birrës atëherë një ide fitimprurëse mund të jetë ta prodhoni dhe jo ta konsumoni atë. Kjo ide ju prezanton me mini aparatën shtëpiakë për prodhimin e birrës me sasi të kufizuar. Ky aparat mund të vendoset në një ambient të vogël në shtëpi apo dyqan dhe ju mund të prodhoni birrë cilësore për kërkesat e komunitetit dhe familjeve përreth jush. Duke parë çmimet e larta të produkteve të ngjashme sot në tregje, kjo ide ka avantazhin e kostove më të ulëta dhe të një cilësie e cila varet nga përbërësit dhe mënyra që ju do të përdorni. Birra mund të shërbehet me shishe 1,5 litërshe e cila përshtatet me nevojat e komunitetit.

Kapitali i nevojshëm: 80,000 – 150,000 Lekë (blerje pajisje, reklama, pajisje shitje)

Vendi Ideal: Ky produkt mund të vendoset për prodhim në ambiente familjare dhe të tregëtohet në komunitete të ndryshme urbane por edhe rurale përmes shpërndarjes.

Numri i Personave: 1 – 2 persona

Info:

<http://beersmith.com/blog/2009/01/10/how-to-brew-beer-5-steps-for-making-beer-at-home-part-1/>



86 POSTIER ME BIÇIKLETË

Sektori: Shërbime

Përshkrimi: Në rast se jeni person energjik dhe ju pëlqen sporti atëherë mund të krijoni një aktivitet duke ofruar shërbime postare apo dërgesa malli me biçikletë. Kjo mënyre shërbimi është kthyer në një mjet shumë efikas në shumë vende për shkak të shpejtësisë dhe koston e ulët. Ju mund të ftoni disa nga miqtë tuaj që ti bashkohen kësaj nisme dhe të ofroni këtë shërbim në qytetin ku jetoni. Për ndërtimin e një aktiviteti të tillë do tju nevojitet eksplorimi i formave të shërbimit në zonën tuaj, një plan marketingu për të reklamuar shërbimin, disa biçikleta dhe një ambient i vogël i cili do të shërbejë si qendër për telefonatat, mbajtjen e llogarive, adresave dhe pakove në raste të ndryshme. Kjo ide ka shanse të larta suksesi në zona urbane për shkak të trafikut të madh dhe infrastrukturës së ngushtë.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 – 200,000 Lekë (blerje biçikletash, kompjuter, mjete reklamimi etj)

Vendi Ideal: Ky produkt mund të vendoset për prodhim në ambiente familjare dhe të tregëtohet në komunitete të ndryshme urbane por edhe rurale përmes shpërndarjes.

Numri i Personave: 1 – 4 persona



87 KUMPIRI

Sektori: Ushqim, Tregëti

Përshkrimi: Në Turqi ka një produkt ushqimor shumë të veçantë dhe interesant. Siç e dimë ballkani ka ngjashmëri të mëdha në traditën e gatimit dhe artikujt por ideja e Kumpirit nuk është present në shumë vende. Ky produkt futet në kategorinë "fast food" dhe përbëhet nga përbërës të thjeshtë ku kryesori është patatja. Patatja luan rolin kryesor duke zëvendësuar bukën dhe mbushet Brenda saj me produkte të ndryshme sipas shijeve. Ky artikull në vetvete ofron cilësi të lartë dhe çmim konkurrues për klientët. Gjithashtu të qenit i veçantë krahasuar me produktet klasike të fast food-eve e bën atë tërheqës dhe të suksesshëm.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 – 150,000 Lekë (blerje materialesh)

Vendi Ideal: Ju mund ta konsideroni këtë ide si diçka ambulatorye të lëvizëshme ose të qëndrueshme duke hapur një mini aktivitet si fast food dhe ta shërbeni krahas produkteve të tjera. Ky është një produkt që mund tju bëjë të dallueshëm në qytet.

Numri i Personave: 1 – 2 persona

Info: <http://mediterranean-turkish-food-passion.blogspot.com/2011/12/loaded-baked-potato-kumpiri.html>



88 PIKË BIÇIKLETASH

Sektori: Shërbime

Përshkrimi: Një nga shërbimet e vjetra në qytetet tona u sfumua dhe u la mënjanë për shumë vite pas futjes në qarkullim dhe dëshirës së madhe të njerëzve për makinat. Por së fundmi shumë njerëz po u rikthehen biçikletave si mjete transporti për shkak të kostove të ulëta, efektit mjedisor dhe kohës së shkurtër krahasuar me qëndrimin në trafik për në punë. Në qytetet tona të vogla biçikleta është një mjet shumë praktik. Nëse besoni sa më lart mund të konsideroni idenë e hapjes së një pike për rregullimin dhe lënien me qera të biçikletave. Ndërkohë që do të rregulloni mjetet e qytetarëve mund të shërbeni edhe turistët dhe vizitorët me mjete me qera kështu që ofroni disa shërbime njëherësh. Përveç shërbime kryesore gjithashtu mund ta ktheni dyqanin tuaj edhe në pikë shitje për aksesorë të ndryshëm që lidhen më këtë mjet për grupmosha të ndryshme. Kjo ide nuk ka nevojë për ndonjë aftësi të amdehe profesionale dhe marrja e njohurive mund të merret edhe përmes stazhit afatgjatë në një dyqan të ngjashëm.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 – 200,000 Lekë (blerje biçikletash, mjete riparimi dhe reklamimi etj)

Vendi Ideal: Ky aktivitet mund të vendoset në ambiente familjare ose në ambiente të marra me qera në komunitete të ndryshme urbane por edhe rurale, zona turistikë dhe të populluara.

Numri i Personave: 1 – 2 persona



89 MIRËMBAJTËS KOPËSHITI

Sektori: Shërbime

Përshkrimi: Kujdesi ndaj pejsazhit nënkupton kujdes ndaj lëndinave, luleve, shkurreve, bimëve dhe hapsirave jashtë shtëpive e ndërtesave. Ai mund të ekzistojë në forma të ndryshme dhe një kompani e tillë mund të ofrojë shërbime të shumta. Materialet varen nga shumëllojshmëria e shërbimeve që do të ofrohen nga biznesi. Për shembull, vegla elementare për mbjelljen e luleve dhe kujdesin ndaj tyre. Apo makineri më të rënda si kositës bari apo pastrues gjethesh. Avantazhet e këtij shërbimi janë: 1- Potencial zhvillimi; 2- Kujdesi ndaj pejsazhit është një shërbim i vlerësuar; 3- mundësia për të punuar jashtë, në mjedis; 4- mund të jetë një profesion që ka brenda edhe krijueshmëri; 5- ka treg për shërbime të tilla.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 – 300,000 Lekë (pajisje për prerjen dhe mirëmbajtjen e kopshteve)

Vendi Ideal: Ky shërbim mund të ofrohet në zona të banuara me nivel të lartë ekonomik dhe tek subjektet e biznesit si hotele, restorante etj.

Numri i Personave: 1 – 2 persona



90 BIZNES PAKETIMI

Sektori: Shërbime

Përshkrimi: Paketimi i mallrave është një nevojë e shumë kompanive që nga ato ushqimore e deri tek industrialet. Gjithashtu nevoja për paketime të ndryshme është e pranishme edhe ne bizneset më të vogla familjare. Kjo ide mund të jetë e përshtatshme për tu ofruar për klientë të ndryshëm duke marrë porosi për ta e duke bërë atë çka konsiderohet deri diku “angari” dhe jo shumë efektive në kohë. Paketimi i mallrave për produkte të ndryshme mund të jetë i përmasave të mëdha ose shumë të vogla në varësi të artikujve. Kjo ide mund të ketë efekt pozitiv pasi përveç jush mund të punësohen edhe antarë të tjerë të komunitetit të cilët kanë nevojë për punë. Ju mund të organizoni një grup të gatshëm dhe prezantoni shërbimin tuaj tek persona apo firma të ndryshme në zonën ku jetoni dhe më tej.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 – 200,000 Lekë (material të ndryshme për paketimin)

Vendi Ideal: Zona periferike urbane, ambjent me qera të ulët.

Numri i Personave: 3 – 10 persona



91 BANDË MUZIKORE

Sektori: Muzikë, Shërbime, Argëtim

Përshkrimi: Muzika mbetet në çdo kohë një mënyrë për të argëtuar njerëzit dhe zë një rol të rëndësishëm në festat familjare dhe jo vetëm. Teknologjia ka përparuar në ditët e sotme duke e bërë muzikën më shumë pjesë të tregëtisë sesa kënaqësisë. Gjithsesi në rast se keni aftësi muzikore ne ju sugjerojmë që ti përdorni ato për ndryshimin e gjendjes tuaj dhe për gjenerim të ardhurash. Krijimi i një grupi muzikor është një mundësi e mirë që ju të angazhoheni në një aktivitet të mirfilltë profesional me ndihmën e një buxheti fillestar me kosto të ulët. Grupin tuaj muzikor mund ta reklamoni në festa të ndryshme duke filluar pa pagesë, dhe më pas mund të shtoni aktivitetin tuaj me pagesë pasi tu trgoni njerëzve atë që dini të bëni.

Kapitali i nevojshëm: 250,000 – 350,000 Lekë (mjete të përdoruar muzikore)

Vendi Ideal: Ky shërbim mund të ofrohet në zona të banuara urbane dhe rurale. Mund të ofrohet në zona ku nuk ofrohet si shërbim dhe nuk ka shumë konkurrencë. Gjithashtu aktiviteti mund të reklamohet në internet përmes rrjeteve sociale.

Numri i Personave: 4 – 5 persona



92 BIZNES EXPORTI

Sektori: Tregëti

Përshkrimi: Shqipëria prodhon artikuj cilësor të shkëlqyer, që nuk gjenden në tregjet ndërkombëtare. Një ide shumë e mirë biznesi është të mbledhësh këto artikuj nga rajone të ndryshme të Shqipërisë e ti shesësh jashtë për eksport. Ky mund të jetë një biznes shumë i suksesshëm në rast se bëhet me reklamimin, ambalazhimin dhe etiketimin e duhur. Avantazhet mund të jenë: 1- produkte të njohura në të gjithë botën; 2- ka shumë kërkesë ndërkombëtare për këto produkte; 3- potencial zhvillimi i shkëlqyer për komunitetet

Kapitali i nevojshëm: 300,000 – 500,000 Lekë

Vendi Ideal: Meqë kjo ide biznesi është për produkte të cilat mund të mbliidhen në mbarë vendin dhe shitjen e tyre jashtë, biznesi mund të ekzistojë kudo në vend. Gjithsesi do të kërkojë udhëtime në të gjithë vendin.

Numri i Personave: 2 – 5 persona



93 INSTALIM MPIANTE MUZIKOR


Sektori: Shërbime

Përshkrimi: Ideja për të ofruar shërbime për kasetofona dhe impinate muzikore për automjetet mund të jetë një mundësi e mirë punësimi për të gjithë ata që kanë aftësi profesionale por edhe dëshirë për tu marrë me pajisjet elektronike. Nevoja për shërbime të tilla është e lartë pasi këto pajisje kanë një konsum të vazhdueshëm nga përdorimi dhe shpeshherë nevojitet prania e një personi të specializuar për rregullimin e tyre. Ju mund të krijoni një aktivitet të lëvizshëm, një aktivitet të bazuar në një ambient tuajin personal apo me qera. Kjo ide nuk kërkon një hapësirë të madhe. Cilësia e punës tuaj është tregues për vazhdimin e suksesshëm të aktivitetit.

Kapitali i nevojshëm: 100,000 – 150,000 Lekë (pajisjet profesionale, pajisje për mobilimin e dyqanit).

Vendi Ideal: : Zona urbane, zona me trafik dhe popullsi të dendur.

Numri i Personave: 2 – 5 persona



94. QENDRA PËR PUNËSIMIN E KATEGORIVE VULNERABEL

Sektori: Shërbime, Punësim

Përshkrimi: Punësim është sot një nga çështjet dhe nevojat kryesore të shoqërisë për shumë kategori. Në rast se ju pëlqen të ndihmoni njerëz dhe keni aftësi komunikuese mund të mendoni të organizoni një shërbim punësimi për të rinjtë e komunitetit tuaj. Kjo ide ngjan më shumë me një program social i cili, nëse organizohet mirë, mund të jetë një ide interesante për shumë donatorë, të cilët mund të duan ta financojnë atë. Ndihma për komunitetin nga vetë anëtarë të komuniteti është një model i mirë për të rinjtë. Kjo ide mund të funksionojë me ngritjen e një qendre të vogël koordinimi dhe përmes lidhjeve të mira me biznesin e zonës. Një listë me aftësitë e antarëve të komunitetit dhe të rinjve ku jetoni është një mënyrë e mirë për të filluar këtë aktivitet. Avantazhet e këtij aktiviteti janë: 1. Ndihma për të rinjtë e papunë në nevojë, 2. Angazhimi i të rinjve në aktivitete për komunitetin, 3. Prezantimi i aftësive të të rinjve tek biznesi.

Kapitali i nevojshëm: 350,000 – 500,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona urbane, zona populsi të dendur dhe pranë komuniteteve.

Numri i Personave: 3 – 5 persona (mund të konsiderohen edhe disa vullnetarë)



95 NETËT RROME

Sektori: Argëtim

Përshkrimi: Komuniteti Rom ka një traditë të pasur vlerash, ritesh dhe kulture të cilat mund të prezantohen përmes shfaqjeve të organizuara me muzikë dhe element të tjerë. Antarë të një komuniteti të cilët kanë aftësi në disa fusha artistike si muzikë, këngë, recitim, valle etj, mund të organizohen në një grup i cili të ofrojë shfaqje të ndryshme në qytete, zona të banuara e lokale të ndryshme. Një përpunim i mirë i vlerave rrome në një program të caktuar i ndërthurur me veshje shumëngjyrëshe Rrome pa dyshim do të ishte diçka shumë interesante për shumë subjekte të cilat do të donin të thyenin monotoninë e programeve të tyre. Gjithashtu promovimi i kulturës Rrome do të kishte një shans të madh përmes këtij aktiviteti i cili mund të financohet edhe nga donator të ndryshëm

Kapitali i nevojshëm: 350,000 – 500,000 Lekë (veshje, instrumenta, material, transport)

Vendi Ideal: Një ambient kryesor për ndërtimin e numrave të programit dhe aktivitete lëvizëse në të gjithë vendin

Numri i Personave: 5 – 10 persona



96 MARKET LËVIZËS

Sektori: Tregëti

Përshkrimi: Një mjet lëvizës tre apo katër rrotësh i vogël mund të jetë çelësi juaj drejt një sukses të sigurtë. Kjo ide ju vjen në ndihmë atyre që kanë dëshirë tregëtinë dhe dëshirojnë të kenë një dyqan të tyre. Duke parë se dyqanet kushtojnë shumë dhe konkurrenca është e madhe me një mjet të tillë ju e zgjidhni vetë klientelën dhe produktin që do të shisni. Lëvizshmëria ju ofron shanse që një dyqan statik nuk ju jep kurrë. Nëse bëni një studim të mirë të nevojave të zonave të caktuara ju mund të ofroni ato produkte që nuk i ofrojnë të tjerët, ose mund ti dërgoni ato produkte në vendin e duhur më shpejt se të tjerët.

Kapitali i nevojshëm: 350,000 – 500,000 Lekë (mjet i motorizuar, mallra)

Vendi Ideal: Zona urbane, zona rurale, zona populsi të dendur dhe pranë komuniteteve. Aktivitet i lëvizshëm.

Numri i Personave: 3 – 5 (mund të konsiderohen edhe disa vullnetarë)



97 BUTIK BAR ARTIZANAL

Sektori: Shërbime, Tregëti

Përshkrimi: Kjo ide është kombinimi i barit / lokalit me dyqanin e veshjeve apo sendeve. Nëse prodhoni produkte artizanale ato pa dyshim që konsiderohen edhe si produkte të traditës të cilat mund të ekspozohen në vitrina jo vetëm për tu blerë por edhe për tu shijuar për vlerat e tyre. Në rastin e kombinimit të një ambjenti të përbashkët të shërbimit të pijeve me shitjen ju do të rrisni shanset për më shumë klientë. Sugjerohet që ambjenti të kompozohet me pajisje dhe mobilim të ngjashëm me dyqanet dhe shërbimi të jetë i orientuar drejt shijes dhe delikatesës. Në këtë ambient mund të ekspozohen veshje të ndryshme të prodhuara me dorë, prodhime bakri, metali, kashte, bizhuteri etj të cilat janë joshëse për turistë, vajza, gra e kategori të tjera.

Kapitali i nevojshëm: 350,000 – 500,000 Lekë (pajisje, qera, material)

Vendi Ideal: Qendra qytetesh, zona historike, ambiente të populluara

Numri i Personave: 2 – 3 persona



98 PASTRIM PROFESIONAL AMBJENTESH

Sektori: Shërbime pastrimi

Përshkrimi: Një mundësi punësimi për ju dhe për një grup më të madh personash është ofrimi i shërbimeve të organizuara të pastrimit për individë, biznese apo qytete. Ndjeshmëria që një organizim i tillë vjen nga qyteti është e madhe dhe shumëkush do të donte ta ndihmonte këtë iniciativë por të qenit i suksesshëm nënkupton formimin e një shërbimi profesional me mjetet e duhura për pastrime në fusha të ndryshme. Eksperiencia e dikujt nga komuniteti mund të jetë e dobishme ose mund të profesionalizohet dhe familjarizohet me shërbimet pranë një firme ekzistuese pastrimi duke ofruar vullnetarisht punën tuaja. Në grupin tuaj persona të ndryshëm mund të orientohen në drejtime të ndryshme për të mbuluar sa më shumë shërbime në rast të marrëveshjeve të caktuara.

Kapitali i nevojshëm: 350,000 – 500,000 Lekë (mjete, vegla pune, pajisje, uniforma etj)

Vendi Ideal: Zona urbane, zona populsi të dendur dhe pranë komuniteteve.

Numri i Personave: 4 – 10 persona



99 SHTEPI TË PËRBALLUESHME

Sektori: Strehim, Shërbime

Përshkrimi: Kjo ide është një ndërthurje e punës humanitare me atë profesionale në funksion të ndihmës për katëgoritë në nevojë për strehim. Duket një ide e madhe por jo e pamundur. Nëse jeni krijues mjaftueshëm mund të organizoni një grup njerëzish të profesionit të ndërtimit dhe të ndërtoni shtëpi me kosto të ulët për familje me të ardhura të pakta. Një mundësi është ndërtimi i shtëpive nga kontenierët e transportit të mallrave. Një kontenier i përdorur kushton rreth 1500 dollarë dhe me pak punë mund të adoptohet në një shtëpi të fortë dhe të qëndrueshme për një familje. Nëse puna ju shkon mirë me produktet e para më pas vazhdimësia është e lehtë. Këto shtëpi mund të financohen nga vetë individët përmes një pagese të ndarë në disa faza ose përmes bashkëpunimit me donator apo institucione shtetërore. Kjo ide sjell një efekt pozitiv tek të pastrehët që nuk kanë mundësi të blejnë apartamentet normale. Gjithashtu këto shtëpi mund të vendosen në çdo vend.

Kapitali i nevojshëm: 500,000 – 1,000,000 Lekë

Vendi Ideal: Zona urbane, zona populsi të dendur dhe pranë komuniteteve.

Numri i Personave: 3 – 5 (mund të konsiderohen edhe disa vullnetarë)

Info: <http://www.residentialshippingcontainerprimer.com>



100 GJENERATORËT ME ERË

Sektori: Energji, Shërbime

Përshkrimi: Nevoja për energji elektrike ka qenë e lartë që prej shpikjes së saj dhe vazhdon të mbetet një temë e rëndësishme për të gjithë botën. Edhe sot që po flasim një pjesë e popullsisë në botë vuan nga kufizimi i energjisë duke sjellë në këtë mënyrë një seri efektesh negative në jetën e njerëzve që lidhen me ushqimin, higjenën, shëndetin, arsimin etj.

Por natyra është bujare dhe na ofron mundësi të ndryshme për ta krijuar energjinë edhe në mënyrë të pavarur nga sistemet qëndrore botërore. Kjo është pra gjenerimi i energjisë elektrike përmes erës. Përveç faktit që secili mund të blejë në ditët e sotme një gjenerator me erë kjo ide vjen edhe si një mundësi biznesi për tregun lokal duke i ardhur në ndihmë shumë personave të cilët duan të kenë një mundësi ekologjike dhe të pavarur. Në ditët e sotme ne shpenzojmë jashtëzakonisht shumë para për të zëvendësuar mungesën e energjisë me gjeneratorët klasik me naftë për hir të kostove të kësaj të fundit. Por mos harroni edhe zhurmën dhe ndotjen që këta shkaktojnë. Imagjinoni një gjenerator me erë i cili vendoset në ballkonin tuaj në katin e 5-të apo taracën e pallatit tuaj dhe ju siguron energji pa pagesë, pa zhurmë dhe pa ndotje sa herë që dritat shkëputen. Imagjinoni një shtëpi në fshat ku dritat janë jo ekzistente më së shumti e cila furnizohet përmes erës e cila nuk mungon kurrë. Por nuk mbaron me kaq. Gjeneratorë të tillë familjarë mund të zëvendësojnë deri në 70 % të nevojave të një familje duke ulur në maksimum kostot mujore të energjisë. Të gjitha këto nevoja mund të plotësohen përmes hapjes së një biznesi i cili ofron sisteme të tilla për shitje. Investimi fillestar i një klienti kërkon një shumë të konsiderueshme por është thjesht një investim fillestar e më pas kursen. Mund të përdoret gjithashtu mundësia e kreditimit për klientët duke i lehtësuar ata nga pagesa e plotë që në fillim.

Kapitali i nevojshëm: 500,000 – 1,000,000 Lekë (kapitali fillestar për blerje gjeneratorësh)

Vendi Ideal: Zona urbane, zona populsi të dendur dhe pranë komuniteteve.

Numri i Personave: 2 – 3

REFERENCA:

Author, Trend Hunter Inc. Toronto, Ontario, Canada (Date of publication: 2012).

Retrieved from

<http://www.trendhunter.com/slideshow/innovative-business-trends>

100 innovative business ideas 2011(Web Blog. Source: Springwise.com).

Retrieved from

<http://anewbusinessforyou.blogspot.com/2011/06/100-innovative-business-ideas-2011.html>

Author, Daniel Bukszpan, Entrepreneur (June 7, 2013). 10 of the most innovative small businesses.

Retrieved from

<http://www.entrepreneur.com/article/226940>

Author, StartupBizHub, (2013). Innovative Business Ideas.

Retrieved from

<http://www.startupbizhub.com/>

ANEKS: PLAN I BIZNESIT

Një plan biznesi përgatitet në mënyrë që kur jeni duke planifikuar të hapni një biznes / aktivitet të jeni në gjendje të eliminoni sa më shumë të papriturat dhe të jeni të përgatitur për hapat e nevojshëm. Një plan i këtij lloji ju ndihmon të parashikoni pengesat që mund tju dalin në lidhje me mbarëvajtjen dhe me zgjerimin e biznesit. Përveç kesaj ky plan do tju ndihmojë të përcaktoni afate të rëndësishme lidhur me biznesin tuaj. Një plan i tillë i suksesshëm ju lejon që në të ardhmen ju të keni më shumë hapësira për partneritete të ndryshme dhe të keni mundësi të kërkonti hua në banka.

Disa nga pikat që përfshin një plan biznesi janë si më poshtë:

Përmbledhja

1. Përmbledhja është një paraqitje e përgjithshme e planit tuaj të biznesit. Në këtë përmbledhje përfshihen pika kyçe të planit tuaj të biznesit. Në këtë përmbledhje përfshihen emri i themeluesitose atij që krijon aktivitetin, vendndodhja e biznesit, produkti / shërbimi i ofruar si dhe inestitorët ose mënyrat e financimit të idesë.

Përshkrimi i tregut

2. Një nga përbërësit kryesorë të këtij plani është dhe analiza e tregut e cila përfshin përshkrimin e tregut ku biznesi / shërbimi do të operojë në të ardhmen. Keshillohet që në këtë vlerësim të përfshihen konkurentet e mundshëm, tregu ku do të operohet si dhe fusha në të cilën përfshihet biznesi / shërbimi.

Përshkrimi i biznesit

3. Një përshkrim i biznesit / shërbimit është i nevojshëm pasi duhen shpjeguar ato pjesë që e bëjnë idenë tuaj të funksionojë. Për shembull, përcaktoni arsyen pse ju po e hapni këtë biznes / shërbim dhe nevojat që do të plotësojë për konsumatorët. Kushtojini rëndësi edhe diskutimit në lidhje me teknologjitë që ju do të përdorni për krijimin dhe shpërndarjen e produktit ose shërbimit tuaj.

Organizimi dhe Menaxhimi

4. Ky seksion i planit ju ndihmon të përcaktoni se çfarë organizimi dhe ndarje për pozicionet e punës do të ketë biznesi juaj dhe kush do të jetë drejtuesi i këtij biznesi. Gjithashtu është e nevojshme të ketë një plan të qartë për sa i përket menaxhimit.

Shitjet

5. Siguroni informacion për shitjet dhe strategjitë e reklamimit. Këshillohet të përcaktoni në mënyrë të qartë strategjitë e marketimit, zgjerimit, shpërndarjes dhe komunikimit me klientët. Nëse ideja juaj përfshin shitjen nëpërmjet një grupi me personat të tjerë, diskutoni planet për bashkëpunimin me ta, trajnimin dhe pagesat.

Produkti

6. Seksioni i produktit shpjegon çdo detaj në planin tuaj të biznesit në lidhje me produktin ose shërbimin që ju do të hidhni në treg. Rekomandohet që ju të shkruani një përshkrim të detajuar të produktit tuaj në mënyrë që të shpjegoni se çfarë të mirash do të sjellë ky produkt për konsumatorin. Ky përshkrim duhet të përfshijë dhe avantazhet që paraqet produkti juaj lidhur me konkurentët në treg.

Analiza Financiare

7. Kjo analizë tregon fitimet tuaja në këtë biznes. Nëse biznesi juaj është i ri atëherë duhet të shikoni mundësinë e gjetjes së financimit dhe parave, ndërsa nëse është një biznes ekzistues por ju jeni duke e përpiluar këtë plan në mënyrë që të zgjeroheni atëherë përfshini lista të ndryshme me përfitime ose humbje gjatë 2-5 viteve të fundit.

PLAN PËR BIZNES TË VOGËL

1. TË DHËNA PERSONALE

Mbiemri:	Emri:
Adresa e banimit:	
Nr. telefoni:	Adresa e-maili:

2. INFORMACION I PËRGJITHSHËM RRETH BIZNESIT TUAJ

Lloji i biznesit:

Vendi:

Ky biznes është:

I ri rifillon zgjerohet

A është e nevojshme të aplikoni për licensë biznesi?

Po Jo, e kam një te tillë Nuk është e nevojshme

3. EXPERIENCA DHE AFTËSITE

Arsim formal:

Arsim/formim profesional:

Aftësi të tjera:

Gjendja social-ekonomike:

A keni nevojë të merrni trajnime shtesë për të mundësuar funksionimin e biznesit tuaj? Nëse po, çfarë lloj trajnimi?



4. PËRSHKRIMI I BIZNESIT

Ju lutemi, përshkruani shkurtimisht biznesin tuaj:
(Cfarë produkti ose shërbimi do të ofroni dhe si?)

5. PLANI I MARKETINGUT

Ju lutemi përshkruani planin tuaj të marketingut: (Si planifikoni të tërhiqni klientët tuaj?)

6. PLANI PËR PERSONELIN

Ju lutemi përshkruani planin për personelin:
(A planifikoni të punësoni staf? Nëse po, sa? Cilat aftësi dhe / ose experience duhet të kenë ata?)

7. BUXHETI

Ju lutemi, paraqisni kostot dhe përshkrimin e burimeve të nevojshme për biznesin. Tregoni kush pritet të financojë:

	<u>Ju</u>	<u>TË TJERË</u> (Partner biznesi, të afërm, miq etj.)	<u>TOTALI</u>
<u>Materialet:</u>			
<u>Pajisjet:</u>			
<u>Regjistrim biznesi:</u>			
<u>Të tjera: (qera* etj)</u>			
<u>Të tjera(tavolina, rafte etj)</u>			
<u>TOTALI:</u>			



8. LLOGARITJA E FITIMIT

Ky seksion ju ndihmon llogaritjen e të ardhurave tuaja mujore. Ju lutemi, plotësoni këtë seksion brenda mundësive tuaja më të mira.

8.1. LLOGARITJA E FITIMIT GROS

Ju lutem specifikoni produktet/shërbimet dhe sasinë që ju do jeni në gjendje të ofroni në një muaj.

Lloji i produktit / shërbimit	Cmimi	Sasia	çmimi * sasia
FITIMI TOTAL GROS:			

A do jetë në gjendje biznesi juaj të ofroje shërbime ose produkte gjatë gjithë vitit?

Nëse jo, si do ndikojë kjo tek të ardhurat tuaja mujore?

8.2. LLOGARITJA E KOSTOVE

Ky seksion ju ndihmon të llogarisni kostot për të zhvilluar biznesin tuaj. Ju lutemi specifikoni kostot për të prodhuar produktet e mësipërme:

Tipi	Kosto
Materialet (specifikoni):	
1.....	
2.....	
3 Qera	
Kosto komunikimi: telefon etj	

.....

Të tjera:	
Transport / mirëmbajtje:	
Qera:	
Rroga:	
Shpenzime të tjera (përshkruaj):	
1...Taksa.....	
3...Sigurime.....	
KOSTO TOTALE:	

8.3. LLOGARITJA E FITIMIT NETO: Ky seksion ju ndihmon të llogarisni atë që ju do të fitoni pasi kostot të jenë zbritur nga fitimi juaj gros. $\text{Fitimi gros} - \text{kostot} = \text{Fitimi neto}$

Ju lutemi, bëni llogaritë e nevojshme:

Fitimi total gros:

Kosto totale:

Taksa mbi fitimin e përfshirë në linjat e mësipërme :

FITIMI TOTAL NETO:

9. KONKURENCA

Kush janë konkurentët në biznesin tuaj?

- 1.
- 2.
- 3.



A planifikoni tu ofroni klientëve tuaj produkte / shërbime të ndryshme nga konkurentët tuaj? A do ketë biznesi juaj një avantazh më shumë nga konkurentët tuaj?

10. RREZIQET

Ju lutemi, tregoni rreziqet kryesore me të cilat do të përballeni kur të krijoni / zhvilloni biznesin tuaj? Si planifikoni t'i zgjidhni ato?

11. PLANET AFATGJATA

Cilat janë planet tuaja afatgjata në lidhje me këtë biznes?



